

Bekim Morina
Skender Mekolli

**MUNGESAT E NXËNËSVE NË PROCESIN
MËSIMOR NË SHKOLLAT E MESME TË
LARTA NË KOSOVË**

Prishtinë, 2016



**INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PRISHTINË**

BEKIM MORINA
SKENDER MEKOLLI

**MUNGESAT E NXËNËSVE NË PROCESIN MËSIMOR
NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA NË KOSOVË**

Prishtinë, 2016

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Labëri Luzha

Autorë:

Bekim Morina

Skender Mekolli

Recensent:

Mimoza Shahini, MD, PhD

Këshilli Shkencor i IPK-së:

Prof.Dr. Hajrullah Koliqi

Prof.Dr. Naser Zabeli

Prof.Dr. Hatixhe Ismajli

Prof.Dr. Linda Grapci

Mr.Sc. Blerim Saqipi

Korrektues gjuhësor:

Bedri Zyberaj

Përgatitja teknike:

Skender Mekolli

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	7
Summary	9
I. HYRJJE.....	11
II. KONTEKSTI TEORIK.....	14
2. 1. Paraqitja e problemit	14
2. 2. Vijueshmëria	16
2. 3. Mbështetja e nxënësve.....	17
2. 4. Shkaqet dhe pasojat e mungesave	19
2. 5. Komunikimi dhe bashkëpunimi	22
2. 6. Tipat e mungesave.....	25
2. 7. Ikjet nga orët e mësimi.....	27
2. 8. Përrjashtimi e nxënësve nga orët mësimore	29
2. 9. Legjislacioni	30
2. 10. Sanksionet	33
2. 11 Përvojat ndërkombëtare dhe masat e ndërmarra	36
2. 13. Përvojat vendore dhe masat e ndërmarra	43
III. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	47
3. 1 Qëllimi i hulumtimit.....	47
3. 2. Pyetjet hulumtuese	47
3. 3. Lloji i hulumtimit	48
3. 4. Popullacioni dhe mostra	48
3. 5. Metodatat e hulumtimit	49

3. 6. Teknikat dhe instrumentet e hulumtimit	49
3. 7. Procedura e mbledhjes së të dhënave	50
3. 8. Analiza e të dhënave	51
IV. REZULTATET E HULUMTIMIT DHE INTERPRETIMI	
I TYRE.....	52
4. 1. Rezultatet e dala nga nxënësit dhe mësimdhënësit	53
4. 1. 1. Ikja e nxënësve nga orët e mësimit	57
4. 1. 2. Përfundimi i nxënësve prej orëve nga mësimdhënësit	59
4. 1. 3. Dallimet ndërmjet shkollave profesionale dhe gjimnazeve	66
4. 1. 4. Propozimet dhe sugjerimet e nxënësve dhe të mësimdhënësve	69
4. 2. Rezultatet e dala nga intervistat me drejtorët e shkollave	70
V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	81
5.1. Përfundime	81
5.2. Rekomandime	83
Burimet dhe literatura	86

SHKURTESAT

MAShT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
UA	Udhëzimi Administrativ
KDSh	Këshilli Drejtues i Shkollës
CTREQ	Qendra e Transferit për Sukses Arsimor e Kvebekut
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
EPRBM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe mosregjistrimit

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1	Mungesat nga orët e mësimit	53
Grafiku 2	Lëndët në të cilat nxënësit mungojnë më së shpeshti	54
Grafiku 3	Arsyet e mungesave në orët e mësimit	55
Grafiku 4	Evidentimi i mungesave në ditat	56
Grafiku 5	Ikja e nxënësve nga mësimi	57
Grafiku 6	Arsyet e ikjes së nxënësve nga mësimi	58
Grafiku 7	Frekuenca e nxjerrjes së nxënësve nga orët e mësimit	59
Grafiku 8	Vendqëndrimi i nxënësve të përjashtuar nga ora mësimore	60
Grafiku 9	Përgjegjësit për mungesat e nxënësve	61
Grafiku 10	Ndikimi i kujdestarit të klasës në zvogëlimin e mungesave	62
Grafiku 11	Pasojat nga mungesat e shumta	63
Grafiku 12	Mungesat e nxënësve sipas tipit të shkollave..	66
Grafiku 13	Shpeshësia e ikjeve të nxënësve nga orët mësimore	67
Grafiku 14	Numri i mungesave të nxënësve	70
Grafiku 15	Orët në të cilat nxënësit mungojnë	71
Grafiku 16	Arsyet e mungesave	72
Grafiku 17	Arsyet e ikjeve nga orët e mësimit	73
Grafiku 18	Vendqëndrimet e nxënësve që ikin ose përjashtohen nga orët e mësimit	74
Grafiku 19	Frekuenca e përjashtimit të nxënësve nga orët e mësimit	75
Grafiku 20	Përgjegjësit për mungesat e nxënësve në shkollë	76

Përmbledhje

Qëllimi i hulumtimit është të kuptojmë se sa nxënësit, në shkollat e mesme të larta në Kosovë, e ndjekin me rregull mësimin, sa janë të shpeshta mungesat, cilat janë shkaqet dhe pasojat që nxënësit mungojnë në procesin mësimor, si dhe masat që kanë ndërmarrë shkollat dhe institucionet e tjera përgjegjëse për eliminimin apo zvogëlimin e mungesave.

Për realizimin e studimit janë përdorur pyetësorë për prindër dhe mësimdhënës, si dhe intervista gjysmë të strukturuar me drejtorë të shkollave. Të dhënat janë analizuar përmes programit Excel. Në hulumtim janë përfshirë 400 nxënës të klasave të dhjeta (nga 25 nxënës në një shkollë – të disa paraleleve. Aty ku kishte më shumë paralele janë marrë nga 5 nxënës për paralele) dhe 64 mësimdhënës (4 mësimdhënës prej një shkolle, kujdestarë klase apo mësimdhënës të klasave të dhjeta), të 16 shkollave, të 8 komunave të Kosovës.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shkaqet e mungesave të nxënësve në procesin mësimor janë të shumta dhe të ndryshme, si mungesa e motivimit, mësimdhënia joatraktive, mbingarkesa e planeve dhe programeve mësimore, mjediset e papërshtatshme shkollore, dhuna dhe presioni, përkujdesja jo e duhur e prindërve, pengesat e udhëtimit, si dhe përdorimi i teknologjisë informative për lojëra dhe komunikime në rrjetet sociale.

Ajo që më së shumti paraqet shqetësim është se në shumicën e shkollave disa mësimdhënës ende vazhdojnë t'i nxjerrin nxënësit nga ora e mësimin, për shkak të prishjes së rendit dhe disiplinës brenda klasës, dhe kjo, tani më ka filluar të kalojë në shprehje të një numër i mësimdhënësve dhe i nxënësve. Prandaj, nxënësit

kanë filluar të kopjojnë njëri-tjetrin në sjellje, me qëllim që mësime të mësuara të përdoren nga ora e mësimi si zgjidhje më e „lehtë” për ta, pa bërë përpjekje që t’i bëjnë pjesë të vendimmarrjes dhe të ndihen të rëndësishëm në klasë.

Përgjegjës kryesorë për numrin e madh të mungesave, sipas nxënësve, janë prindërit dhe kujdestarët e klasës. Ndërsa mësime të mësuara, në një përqindje më të madhe, i fajësojnë prindërit, mbi 76 %, të pasuar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, kujdestarët e klasave dhe drejtorët.

Nga ana e prindërve nuk ekziston ende ndërgjegjësimi i duhur për rolin që ata mund të kenë në vijimin e rregullt të mësimi të fëmijëve të tyre në shkollë, por ky rol i lihet më shumë shkollës dhe mësuesve. Pavarësisht se përfshirja e prindërve në përgjithësi konsiderohet e rëndësishme, shkollat nuk kanë ndonjë program efikas të bashkëpunimit, i cili siguron përfshirjen e të gjithë prindërve në vendimmarrje.

Shkaku i mungesave të paarsyeshme në mësim, nxënës të përballen me pasoja të shumta, si ngecin mbrapa me mësim, suspendohen apo transferohen në ndonjë shkollë tjetër dhe mund të humbin të drejtën e shkollimit.

Përfundimet dhe rekomandimet e dala nga hulumtimi do t’u shërbejnë shkollave dhe institucioneve të tjera arsimore, gjatë hartimit të strategjive dhe rregulloreve, me qëllim të zvogëlimit apo eliminimit të kësaj problematike, në të ardhmen.

Fjalë kyçe: ikje, mësime të mësuara, mungesë, nxënës, përjashtim, prindër, shkollë.

Summary

The aim of the research is to shed light on the regular school attendance of upper secondary school students in Kosovo, on the frequency of absences, the causes and consequences of absences, and the measures undertaken from schools and other competent institutions for the elimination or reduction of absences.

The instruments used to conduct the study consisted of parent and teacher questionnaires and semi-structured interviews with school directors. Data were analyzed using the Excel program. The study sample included 400 tenth grade students (25 students from different classes in each school. Where the number of classes was higher, 5 students were selected from each class) and 64 teachers (4 tenth grade teachers and head teachers) from 16 schools of 8 municipalities in Kosovo.

The study results indicate that causes of student absences from the education process are numerous and various, including lack of motivation, unattractive teaching, overload of school curricula, the unsuitable school environment, violence and pressure, inadequate parent care, travel obstacles and use of Information Technology for games and social network communication.

Most concerning is that in the majority of schools some teachers continue to expel students from class due to order and discipline breaches within class; this has become a habit among many teachers and students. Further, students are copying each other's behaviors in order to be expelled from class. They consider this as an "easier" solution, which spares them from the need to be part of decision-making and feel important in the class.

According to students, the main responsible actors for the high number of absences are parents and head teachers. On the other hand, teachers blame parents (over 76%), followed by Municipal Education Departments, head teachers and school directors.

Parents lack the awareness on the role they can play concerning the regular school attendance of their children; therefore, this role is left to the school and teachers instead. Even though the inclusion of parents is generally considered important, schools do not have any effective cooperation program to ensure the involvement of all parents in decision-making.

Due to unjustified absence from school, students face numerous consequences, such as remaining behind in lessons, suspension or transfer to another school even losing the right to education.

The conclusions and recommendations of the study will serve schools and other education institutions in the drafting of strategies and regulations aimed at reducing or eliminating these problems in the future.

Key words: absence, class expulsion, parent, school, skipping, student, teacher,

I. HYRJE

Arsimi parauniversitar në Kosovë ende është në fazën e tranzicionit, prandaj edhe problemet e sfidat me të cilat përballen shkollat janë të shumta. Ndër problemet aktuale në shkollat e mesme të larta janë mungesat e nxënësve në orët e mësimi: vonesat në orën e parë, ikjet nga orët, si dhe nxjerrjet e nxënësve prej orës së mësimi nga ana e mësimitdhënësve për prishje të rendit dhe të qetësisë në klasë.

Ky fenomen kompleks dhe gjithnjë e më i zakonshëm po bëhet, për fat të keq, trend i nxënësve të shkollave tona, prandaj hulumtimi për mungesat e nxënësve në shkolla është më se i nevojshëm. Tema është me rëndësi të veçantë për faktin se është mjaft aktuale, ka karakter shkencor, arsimor dhe metodologjik, dhe do të ndihmojë nxënësit, mësimitdhënësit dhe prindërit të kenë qasje më të avancuar në parandalimin apo zvogëlimin e numrit të mungesave, në të ardhmen. Ndërmarrja e masave është prioritet që duhet të mobilizojë të gjithë komunitetin arsimor. E drejta për arsim, si rrjedhojë, ka detyrimin e vijimit të rregullt të mësimi, që është kushti i parë për sukses të qëndrueshëm dhe promovim të mundësive të barabarta për të gjithë (Manca, 2004).

Për braktisjen e mësimi nga ana e nxënësve, në Kosovë, janë bërë disa hulumtime. Duke u nisur nga fakti se mungesat e shumta të nxënësve i paraprijnë braktisjes së shkollës, dhe ngaqë mungojnë studimet e mirëfillta të këtij fenomeni me një moshë të caktuar të nxënësve, jemi fokusuar në analizën e gjendjes aktuale në shkollat e mesme të larta në Kosovë.

Raportet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit flasin për shifra të larta në shumicën e komunave të Kosovës, por DKA-të nuk kanë

plane ose strategji të ndërhyrjes për zvogëlimin e mungesave të nxënësve. Mungesat e shumta të nxënësve në orët e mësimit paraqesin rrezik permanent për ndërprerjen e mësimit nga ana e nxënësve. Ato janë shenja të braktisjes së mësimit nga një numër i nxënësve (Deva-Zuna, 2009).

Bazuar në rezultatet e disa hulumtimeve, ka shumë arsye pse nxënësit mungojnë në mësim, si: mungesa e motivimit, mosinteresimi i prindërve për ta, mësimdhënia joatraktive, sjellja jokorrekte ndaj nxënësve, mbingarkesa e planeve dhe programeve mësimore, mjediset e papërshtatshme shkollore, dhuna dhe presioni nga nxënësit problematikë, përkujdesja për familjen, arsyet shëndetësore, pengesat e udhëtimit si dhe përdorimi i teknologjisë informative për qëllime jo mësimore, pasi nxënësit më tepër e kalojnë kohën në rrjetet sociale sesa që merren me mësim. Arsyet më të shpeshta janë mospërgatitja për orën e mësimit, lodhja gjatë qëndrimit në shkollë, ora e mërzitshme ngase nuk u pëlqen lënda ose mësuesi etj. (IPK, 2010).

Një numër i nxënësve janë përgjegjës për të mbajtur familjen dhe detyrohen të lëshojnë orët e fundit ose të mungojnë tërë ditën. Por, pjesa më e madhe e mungesave ndërliken me mësimdhënien dhe nxënien. Shpesh nxënësit ikin nga orët e mësimit, kur nuk janë të përgatitur sa duhet për mësim, në ato lëndë që përgjithësisht i konsiderojnë si të rënda, apo mësimdhënësit kanë kritere të ashpra vlerësimi, duke preferuar më tepër të qëndrojnë larg shkollës, sesa të marrin nota negative. Jo rastësisht, nxënësit që bëjnë më tepër mungesa janë ata që kanë rezultate jo të mira në mësim.

Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe shumica e shkollave në Kosovë, në planet e tyre zhvillimore e kanë përcaktuar si mision

ngritjen e cilësisë në procesin edukativo-arsimor, vijueshmërinë e rregullt, si dhe parandalimin e braktisjes së shkollës, por në ato plane nuk gjinden mjaft aktivitete që parashohin zvogëlimin e mungesave dhe të braktisjes. Shkollat nuk kanë përcaktuar objektiva të qarta për parandalimin e braktisjes dhe zvogëlimin e mungesave të nxënësve në mësim.

II. KONTEKSTI TEORIK

2. 1. Paraqitja e problemit

Mungesat e nxënësve të shkollave të mesme janë dukuri shumë e shpeshtë. Edhe pse vijimi i rregullt është një nga shumë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit nxënës, drejtorët, mësimdhënësit, kujdestarët e klasave dhe prindërit, në çdo vit shkollor, përballen me numrin e madh të mungesave të paarsyeshme të nxënësve. Me këtë problematikë ballafaqohen edhe shumë vende të tjera të botës, përvojat e të cilave tregojnë se problemi i mungesave është i vështirë për t'u zgjidhur, për shkak të faktorëve që ndikojnë dhe qasjes objektive për të vëzhguar numrin e mungesave dhe për të gjetur shkaqet dhe pasojat.

Shtrirja e këtij fenomeni e ka shtyrë komunitetin arsimor të shqyrtojë politikat, të plotësojë dhe të përmirësojë infrastrukturën ligjore, me qëllim të zvogëlimit dhe eliminimit të mungesave dhe pasojave që dalin nga to. Ndërmarrja e masave është prioritet që duhet të mobilizojë gjithë komunitetin arsimor. E drejta për arsim, si rrjedhojë, ka detyrimin e vijimit të rregullt të mësimin, që është kushti i parë për sukses të qëndrueshëm dhe promovim të mundësive të barabarta për të gjithë (Manca, 2004).

Mungesat mund të duken si një shkëlqje normale që përcjell procesin e adoleshencës ose si simptomë e një patologjie sociologjike, por pedagogët (Serge Boimare, Gilbert Longhi), sociologët (François Dubet) dhe psikologët (Annie Cordié, Patrick Delaroche, Daniel Marcelli) fokusohen mbi çështjen shqetësuese të mungesave shkollore, në përpjekje për të përcaktuar shkaqet dhe për të propozuar zgjidhjet (Huerre & Leroy, 2006).

Te një numër nxënësish, mungesat pa arsye, mund të paraqiten si një tipar i ndërtimit të autonomisë në adoleshencë, si afirmim i shijes personale dhe dëshirës për t'u avancuar në shoqëri. Ata janë në gjendje të kritikojnë dhe të mos pranojnë atë që ofron shkolla. Vetë vendosin se çfarë është e rëndësishme për ta dhe çfarë jo, të shkojnë apo mos të shkojnë në një orë mësimi. (Huerre & Leroy, 2006).

Mungesat e nxënësve mund të jenë pasojë e një procesi të demotivimit dhe tjetërsimit në raport me shkollën. Shumë nxënës që mungojnë rregullisht me dëshirë duan të jenë jashtë saj, mes tjerash, për shkak se janë të demotivuar nga përvoja e shkollës ku vijnë mësimin, të frustruar nga dështimet e akumuluar, të poshtëruar dhe të nënvlerësuar në marrëdhëniet e tyre me të tjerët. Përvojat që ata shohin jashtë shkolle (punë, para, konsum, kënaqësia për të qenë anëtar i ndonjë grupi) i largojnë nga „roli i tyre i të qenit nxënës" dhe vënë në pah edhe më tepër ndryshimin në mes të realitetit „për rolin e të nxënës në shkollë" dhe të „të jetuarit jashtë shkolle" (Potvin, 2007).

Tjetërsimi nga shkolla është tregues domethënës i numrit të mungesave. Kjo ndjenjë është e lidhur me orientimet motivuese, ndjenjën e përkatësisë dhe perceptimin e cilësisë së marrëdhënies mësues-nxënës. Mungesat e të rinjve janë pasojë e mungesës së motivimit dhe pasojë e tjetërsimit, megjithatë nuk duhet mohuar se rrethi familjar luan rol në angazhimin e shkollës. Në të vërtetë, mbështetja e familjes dhe ndjenja e tjetërsimit janë të lidhura ngushtë ndërmjet vete (Galland, 2004).

Shumë prej këtyre nxënësve janë të bindur se të mësuarit në shkollë nuk është i dobishëm. Këtë bindje ata e bazojnë në faktin se qëllimi final i të mësuarit është shumë i largët, ose për shkak

se diploma nuk garanton një punë në të ardhmen. Përveç kësaj, nxënësi mendon se të mësuarit nuk sjell shumë në planin intelektual dhe se ai mund të vihet në pozitë të pakëndshme nëse nuk e përvetëson mësimin siç duhet, e si pasojë e kësaj rezulton dështimi. Për këta nxënës, mësimi nuk përfaqëson „jetën reale". Ata mendojnë se shkolla u jep atyre statusin e një fëmije, edhe pse ata janë të rritur (Huerre & Leroy, 2006).

2. 2. Vijueshmëria

Sipas legjislacionit në fuqi, mësimdhënësit sigurohen për praninë e të gjithë nxënësve në shkollë, gjatë tërë kohës sa zgjat orari mësimor. Nxënësit janë të detyruar të marrin pjesë në klasë sipas orarit të paraparë mësimor, përveç nëse kanë ndonjë arsye që i pengon të mos jenë të pranishëm. Në përputhje me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret përkatëse të institucioneve arsimore, pas regjistrimit të nxënësve në shkollë, gjatë mbledhjeve dhe takimeve të para me prindërit, atyre u bëhen të njohura detyrat dhe përgjegjësitë që kanë ata dhe fëmijët e tyre në shkollë, si dhe mundësinë e përfshirjes në çështjet e arsimit dhe të mbështetjes për fëmijët (Circulaire, 2011).

Gjatë takimeve apo diskutimeve me prindër, fokusi bie mbi rëndësinë e pranisë së nxënësve në çdo orë të mësimit. Po ashtu, temë e bisedave është bashkëpunimi i ngushtë në mes të shkollës dhe prindërve, sidomos kur paraqiten vështirësi dhe kur vijimi i rregullt nuk respektohet. Duhet rikujtuar prindërve se, në rast të mosbashkëpunimit dhe vijimit jo të rregullt të fëmijëve të tyre, mund të vjen deri te përjashtimi i tyre nga shkolla.

Regjistri i emrave (ditari), në të cilin shënohen mungesat e nxënësve të regjistruar, për çdo klasë duhet të mbahet në çdo shkollë dhe institucion arsimor. Për mungesat e nxënësve informohet prindi ose personi përgjegjës se në rast të mungesave përgjegjësia mund të rezultojë me penalizëm, e po ashtu edhe prindi informon mësimdhënësin apo drejtorin për arsyen e mungesës së fëmijës në mësim.

Megjithatë, në asnjë dokument të rregullave të sjelljes në shkollë, të miratuara nga DKA-të, nuk janë identifikuar kriteret të cilat përcaktojnë mënyrat e arsyetimit ose joarsyetimit të mungesave të nxënësve. Raportet statistikore tregojnë për numër të madh të mungesave të paarsyeshme, por edhe për numër të madh të mungesave të arsyeshme, të cilat, në mungesë të kriterëve, mund të supozohet se janë arsyetuar pa u mbështetur në kritere bazë, meqë ato nuk ekzistojnë në formë të shkruar (Devetaku-Gojani & Mehmeti, 2014).

Mungesat e nxënësve regjistrohen në një dosje individuale të veçantë, në kohëzgjatjen e vitit shkollor. Dosjet janë të ndara nga të dhënat e përgjithshme shkollore të nxënësve dhe nuk përcillen nga një vit në tjetrin. Ato përmbajnë përmbledhjen e mungesave, duke përfshirë kohëzgjatjen e tyre, arsyet, të gjitha kontaktet me familjen, masat e marra për të rivendosur pjesëmarrjen dhe rezultatet e arritura. Në dosje mund të ketë edhe dokumente të tjera ose pjesë të informacionit rreth mungesave.

2. 3. Mbështetja e nxënësve

Mungesat e nxënësve në shkollë, përveç për mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave, janë shqetësim dhe brengë për familjet që

përballen me këtë problem. Prandaj, është e rëndësishme që nxënësit të mbështeten, përmes mekanizmave të ndryshëm që ndërliken me shkollimin, si udhëzimet për mësimdhënës dhe prindër, trajnimet, kontratat prindërore të përgjegjësive, ndërmjetësimet familjare, mbështetjen sociale dhe ekonomike, etj.

Mbështetja mund të definohet si një monitorim i vazhdueshëm, i rregullt, i thellë dhe i përshtatur për studimin e origjinës së mungesave të nxënësve. Ajo nuk bëhet vetëm për të siguruar kontrollin e frekuentimit, për të regjistruar mungesat dhe për të informuar familjet. Duhet të analizohen shkaqet e problemeve dhe të ofrohet zgjidhje. Për këtë qëllim është e nevojshme të merret parasysh gjendja intelektuale, emocionale, psikologjike dhe sociologjike e nxënësit, që do të thotë aftësitë mendore apo njohëse, ekuilibri emocional apo afektiv, kapaciteti i tij për integrimin social dhe në fund pjekuria fiziologjike (Didat, 1997).

Si pikënisje të çdo veprimi, për të zgjidhë vështirësitë e nxënësve, për të krijuar kushte të favorshme për një mësim të mirë, Didat, propozon të bëhet një vështrim i plotë i personalitetit të tyre dhe për braktisjen e mësimin dhe mungesat pa arsye të nxënësve në procesin mësimor sugjeron që strategjitë për të reduktuar mungesat e nxënësve në përgjithësi të përfshijnë një formë të monitorimit, parandalimit dhe ndërhyrjes, si hapa themelore për zvogëlimin e numrit të mungesave dhe rasteve të braktisjes së shkollës në përgjithësi.

Rekomandohen forma dhe strategji specifike, që mund të përdoren nga shkollat, prindërit dhe komuniteti, për të përmirësuar vijueshmërinë e nxënësve në shkollë dhe të mos mbesin të kufizuara, ngase strategjitë e hartuara deri më tani nuk

janë implementuar në të gjitha shkollat. Aktivitetet e parandalimit të mungesave duhet të jenë me bazë të gjerë dhe të dizajnuara për të edukuar nxënësit, prindërit dhe mësuesit për rëndësinë e vijueshmërisë së shkollës. Ato duhet të përqendrohen, në mënyrë strategjike, te vijueshmëria e nxënësve dhe te komunikimi i vazhdueshëm i mësimitdhënësve me prindërit.

Hulumtuesit dhe politikëbërësit janë përqendruar gjithnjë e më shumë në sistemet e paralajmërimit të hershëm, si një masë e rëndësishme në parandalimin e mungesave të paarsyeshme të nxënësve. Sistemet e paralajmërimit të hershëm „përdorimit në mënyrë rutinore të të dhënave në dispozicion, janë dëshmi e mirë nëse një nxënës ka gjasa të braktisë shkollën" (Heppen & Therriault, 2008).

Një nga hapat e parë drejt përmirësimit është zhvillimi i një sistemi efikas të monitorimit dhe informimit. Shkollat, prindërit dhe komuniteti në përgjithësi nuk mund të përmirësojnë pjesëmarrjen e nxënësve në procesin mësimor nëse ata nuk e kuptojnë se cilët nxënës mungojnë në shkollë. Monitorimi efektiv ndihmon mësimitdhënësit dhe komunitetin për të identifikuar në mënyrë efektive nxënësit që paraqesin potencial për të braktisur shkollën.

2. 4. Shkaqet dhe pasojat e mungesave

Shkaqet që ndikojnë në mosinteresimin e nxënësve për mësim dhe mungesën e tyre në orët e mësimit janë të shumta, si: mungesa e motivimit të nxënësve, mësimitdhënia joatraktive, sjellja jokorrekte ndaj nxënësve, mbingarkesa e planeve dhe programeve mësimore, disiplina e rreptë në shkollë, mjediset e

papërshtatshme shkollore, etj. Po ashtu, edhe dhuna dhe presioni nga nxënësit problematikë, mosinteresimi i prindërve për ta, arsyet shëndetësore, pengesat e udhëtimit, si dhe përdorimi i teknologjisë informative për qëllime jashtëmësimore, pasi nxënësit më tepër e kalojnë kohën në rrjetet sociale sesa që lexojnë libra, ndikojnë që nxënësit të mungojnë në mësim.

Të gjitha këto shkaqe të mungesave mund të klasifikohen në katër kategori: shkaqet shkollore, psikologjike, të rastit dhe sociale (Manca, 2004).

Shkaqet shkollore paraqesin vështirësitë në mësim dhe në përvetësimin e njohurive shkollore. Dështimi i shkollës, mungesa e metodës dhe e autonomisë në punë, mund të çojnë nxënësin në një lloj fobie apo refuzimi ndaj shkollës. Zgjidhja e këtyre shkaqeve varet nga kompetencat e stafit të shkollës, identifikimi i problemeve, analiza dhe zgjidhja, por gjithashtu edhe nga organizimi i mësimdhënies sipas metodologjisë bashkëkohore.

Shkaqet psikologjike paraqesin pengesat për integrimin e suksesshëm dhe zhvillimin e nxënësit në shkollë. Meqë kanë të bëjnë me humbjen e vetëbesimit, vetërespektin, frikën nga e panjohura etj., këto ndjenja e shtyjnë nxënësin drejt një izolimi, apo varësisht nga personaliteti dhe përvoja jetësore e tij, në raporte konfliktuale apo rebelim sistematik me të tjerët. Ndikimi i shkaqeve psikologjike ndryshon nga një individ te tjetri, në varësi të karakteristikave të rrethit të tij familjar, personalitetit dhe cilësisë së integritit të tij në klasë.

Shkaqet e rastit do të thotë probleme dhe incidente të rastit, që mund t'i shtyjnë nxënësit të largohen nga shkolla (probleme në marrëdhëniet me mësimdhënësin, probleme të socializimit, shantazheve, etj.).

Shkaqet sociale janë të përcaktuara nga faktorët që ndikojnë në pozitën e individit në shoqëri, në „hierarkinë shoqërore". Pasiguria sociale, situata e papunësisë, niveli arsimor i prindërve dhe largësia e madhe ndikojnë në angazhimin ndaj shkollës dhe kërkesës për frekuentimin e saj. Familjet me nivel të ulët ekonomik mund të kenë implikime për pozitën e tyre në shoqëri dhe suksesin në shkollë (Manca, 2004).

Gjendja sociale-ekonomike në familje, gjendja shëndetësore e nxënësve, rrethanat e përgjithshme shoqërore, konsiderohen si shkaqe të jashtme. Gjendja ekonomike është faktori kryesor që i motivon dhe i shtyn mësimdhënësit në angazhime të duhura dhe profesionale në procesin mësimor dhe është parakusht për rezultate, në përputhje me kërkesat e standardeve bashkëkohore në mësimdhënie. Motivimi ekonomik kushtëzon edhe motivimin e nxënësve për rezultate më të mira në shkollë, derisa në të kundërtën është faktor dekurajues dhe shkakton humbjen e interesimit për shkollën dhe sistemin arsimor në përgjithësi.

Edhe planet e programet e ngarkuara mësimore, si shkaqe shkollërore, ndikojnë negativisht në motivimin e nxënësve për shkollën dhe procesin mësimor, ngase kërkesat e tepërta dhe mosselektimi i duhur i përmbajtjeve mësimore ndikojnë në humbjen e interesimit të nxënësve për mësim.

Motivet që i shtyjnë nxënësit të mungojnë në orët e mësimimit janë të shumta. Disa prej tyre janë joshja, mosinvestimi i shkollës dhe problemet personale (CTREQ, 2007).

Joshja (nxitja) nga grupi. Një numër i konsiderueshëm nxënësish, bëjnë mungesa nga joshja ose tërheqja e bashkëmoshatarëve të tyre. Adoleshenti preferon më tepër t'i bashkohet këtij grupi sesa të angazhohet në aktivitetet shkollërore.

Mosinvestimi i shkollës. Për disa nxënës, ikjet dhe mungesa në aktivitetet shkollore që nuk janë atraktive për ta është rezultat i mungesës së investimeve në shkollë, qoftë në mësimdhënie apo në infrastrukturën shkollore.

Problemet personale. Janë probleme që manifestohen te nxënësit në formë fobie nga shkolla, si pasojë e pasigurisë dhe dhunës në shkollë apo edhe si pasojë e problemeve të ndryshme familjare (CTREQ, 2007).

Pasojat që mund të kenë nxënësit shpesh i mungesave të paarsyeshme në mësim janë të shumta. Para së gjithash, ata mbesin mbrapa me mësimin dhe bëhen pengesë edhe për nxënësit e tjerë, brenda klasës, dhe mund të suspendohen, të transferohen në ndonjë shkollë tjetër, apo edhe të humbasin të drejtën e shkollimit.

Janë një kategori potenciale e nxënësve që mund të shndërrohen në gjysmanalfabetë ose edhe në delikuentë. Këta nxënës nuk janë të dobishëm pastaj as për familjen dhe as për shoqërinë në përgjithësi. Prandaj, braktisja paraqet një dukuri që pengon zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë. Në shtrirje më afatgjate, braktisja e shkollimit, ndikon në marginalizimin e individëve dhe të grupeve shoqërore, si dhe shfaqjen dhe shtimin e dukurive negative në shoqëri (KEC, 2012).

2. 5. Komunikimi dhe bashkëpunimi

Në të shumtën e rasteve, arsyt, pse nxënësit mungojnë në procesin mësimor, ndërlidhen me shkollën dhe familjen, mungesën e komunikimit të vazhdueshëm dhe mungesën e bashkëpunimit shkollë-familje. Komunikimi i prindërve me

mësimdhënësit, me drejtorin e shkollës dhe personat e tjerë përgjegjës brenda shkollës, ka shumë rëndësi dhe ndikon në uljen e numrit të mungesave nga ana e nxënësve.

Komunikimi i rregullt i mësimdhënësve me prindër në Kosovë përballet me vështirësi të shumta, në mungesë të krijimit të traditës dhe të vetëdijesimit të pamjaftueshëm të një pjese të prindërve. Niveli i ulët arsimor i prindërve, mbingarkesa me angazhimet e tjera, arritjet e dobëta mësimore të fëmijëve, si dhe mungesa e iniciativës së disa mësimdhënësve për të mbajtur takime më të shpeshta me prindërit, janë disa nga arsyet që komunikimi me prindër mbetet akoma i vështirë për mësimdhënësit dhe udhëheqësit e shkollave.

Sa i përket komunikimit ndërmjet drejtorit të shkollës dhe aktorëve të ndryshëm të shkollës, komunikimi me mësimdhënësit është ndoshta një nga faktorët më të rëndësishëm. Kjo mund të thuhet, për shkak të faktit se mësimdhënësit janë agjentë të ndryshimeve (Fullan, 1999).

Pjesa thelbësore e punës edukative-arsimore në shkollë është komunikimi i rregullt, i efektshëm dhe funksional, në mes të mësimdhënësve dhe nxënësve, veçanërisht për nxënësit që tregojnë ngecje në nxënie, por edhe që janë më të ndjeshëm. Komunikimi i kulturuar, funksional dhe bindës është parakusht për motivimin e të gjithë faktorëve relevantë që ndërlidhen me shkollën, me qëllim që të mobilizohen për të ngjallur interesimin e nxënësve për mësim dhe për të arritur rezultate sa më të mira në shkollë.

Dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit më së miri e njohin mësimdhënësit. Ata janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin mësimor, vazhdimisht e vëzhgojnë praninë e nxënësve dhe me të

kuptuar se dikush nga nxënësit nuk ka vijueshmëri të rregullt në mësim, apo dikush nga nxënësit e ka lënë shkollën informojnë drejtuesit e shkollave dhe bëjnë përpjekje që të punojnë bashkë me prindër /familje për të mbështetur kthimin e fëmijës në shkollë (Deva- Zuna, 2009).

Qëllimet e komunikimit në formë të partneritetit me prindërit janë të bazuara në të dhënat e shkollës dhe janë shumëdimensionale:

1. Informatat – lidhur me normën e vijimit të nxënësve në shkollë
2. Njoftimi – me problemet zhvillimore të fëmijës
3. Këshillimi – për mënyrat që duhen ndjekur dhe ndihmën që duhet dhënë fëmijës në lëndë të veçanta mësimi
4. Konsultimet – rreth vështirësive të veçanta të nxënësit në shkollë (GIZ, 2012).

Shkollat duhet të zhvillojnë kulturë të komunikimit, ngase kultura është e lidhur me sjelljet në shkollë, shmangien nga shkolla, si dhe perceptimet e nxënësve për shkollën. Kultura e komunikimit ndërmjet familjes dhe shkollës është akti më i rëndësishëm për individin, prandaj komunikimi në institucionet arsimore, konkretisht në shkolla, ka peshë jashtëzakonisht të madhe, sepse nga kultura e komunikimit varet drejtpërdrejt performanca e përgjithshme e punës në shkollë. Nuk mund të priten rezultate të dukshme në mësimdhënie dhe nxënie pa një kulturë të mirëfilltë, funksionale dhe të suksesshme komunikuese të të gjitha subjekteve në shkollë (Shala, 2014).

Hulumtimet dhe analizat e bëra, nga organizata dhe individë të ndryshëm, në të cilat janë përfshirë organet drejtuese të shkollave, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit etj, nxjerrin në pah defekte dhe mangësi të shumta në kulturën e komunikimit, si fakt shqetësues për organet kompetente përgjegjëse dhe realitetin në arsimin parauniversitar në Kosovë në përgjithësi. Nuk duhet të pritet që prindërit të krijojnë vetë njohuritë e duhura për të ndihmuar fëmijët e vet nxënës, ose për të kontaktuar me shkollën/mësuesit, por, shkolla duhet të jetë ajo që i informon dhe i përfshin prindërit nëpërmjet programeve të partneritetit shkollë-familje-komunitet (Bezati & Hoxhallari, 2011).

Kultura e shkollës shpesh shërben si një katalizator për sjelljet dhe hulumtimet që sugjerojnë se përpjekjet për të përmirësuar shkollën dhe komunitetin duhet të fokusohen në marrëdhëniet mësimdhënës-nxënës, si dhe mjedisin e të mësuarit. Mësimdhënësit duhet të punojnë për të nxitur të mësuarit, që është relevant për nxënësit, dhe të përmirësojnë angazhimin e tyre duke futur forma të ndryshme të teknologjisë mësimore, në mënyrë që nxënësit të jenë më të angazhuar në klasat që janë pozitive, sfiduese (Ramaley & Zia, 2005).

2. 6. Tipat e mungesave

Në literaturë mund të hasim disa lloje të mungesave që nxënësit i bëjnë gjatë vitit shkollor.

Mungesat e vonesës, janë lloji më i shpeshtë i mungesave të nxënësve, të cilët i bëjnë zakonisht nxënësit që jetojnë larg nga shkollat e tyre. Duke qenë se që nga mëngjesi përballen me

udhëtim të gjatë, shpeshherë ata hasin në bllokada të shumta trafiku ose thjesht kanë probleme me transportin.

Mungesat e brendshme, të quajtura gjithashtu „drop in” ose mungesa të zgjedhura. Është fjala për nxënësit që shkojnë në shkollë, por janë të painteresuar. Ata janë në shkollë, por nuk angazhohen në aktivitete. Në raste të tilla, mësimdhënësit thjesht kërkojnë nga ta vetëm që mos ta pengojnë klasën. Për këta nxënës, fakti pse ata shkojnë në shkollë është vetëm sa për të shmangur problemet e mosvijimit (Huerre & Leroy, 2006).

Mungesat kronike, shpesh karakterizohen nga tipare të caktuara, për shembull, refuzimi i shkollës, vonesat në shkollë, si dhe miqësia me bashkëmoshatarë apo vëllezërit dhe motrat që mungojnë nga shkolla. Ky lloj i mungesave paraqitet shumë herët te nxënësit dhe është gjithashtu shpesh i lidhur me përdorimin e drogës dhe depresionin e madh (CTREQ, 2007).

Mungesat „e autorizuara”, të vetmet arsye legjitime për mungesë janë:

- sëmundja e nxënësit (ose një i afërm në qoftë se është potencialisht ngjithëse);
- një manifestim solemn në familje;
- pengesat e shkaktuara nga vështirësitë aksidentale në transport,
- mungesa e përkohshme, kur fëmija është përcjellës i prindërve;

Por, cilado qoftë arsyeja, mungesa duhet të raportohet në administratën e shkollës.

2. 7. Ikjet nga orët e mësimit

Përveç mungesave ditore dhe vonesave në orën e parë, nxënësit shpesh ikin nga orët e mësimit. Sipas një hulumtimi të bërë nga Instituti Pedagogjik i Kosovës për braktisjen e mësimit, rezulton se ikja nga orët e mësimit është shtuar, sidomos në shkollat profesionale, dhe kjo dukuri mund të shpie drejt asaj që nxënësit ta braktisin shkollën plotësisht. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se është i madh numri i nxënësve që ikin nga orët e mësimit gjatë një viti shkollor dhe arsytet më të shpeshta, sipas nxënësve, ishin mospërgatitja për orën e mësimit, lodhja gjatë qëndrimit në shkollë, orët e mërzitshme, nuk u pëlqen lënda ose mësuesi, etj. (IPK, 2010).

Jo vetëm nxënësit që nuk kanë sjellje dhe sukses të mirë ikin nga orët e mësimit, por kjo u ndodh edhe nxënësve të mirë. Zakonisht ikin nxënësit që nuk përgatiten për mësim, që të mos marrin nota negative, dhe për këtë fajtorë janë edhe mësimdhënësit, të cilët nuk i respektojnë standardet për vlerësimin e nxënësve.

Në qoftë se një numër i madh i nxënësve janë të papërgatitur, madje midis tyre ka edhe nxënës të mirë, atëherë vihet në dyshim edhe vetë autoriteti i mësimdhënësit, puna e tij dhe sukcesi në përgjithësi, megjithëse fajin për mosinteresim dhe për sukses të dobët e kanë edhe vetë nxënësit dhe prindërit e tyre. Nxënësit e papërgatitur ikin nga orët, prandaj duhet të zbatohen standardet e vlerësimit dhe mësimdhënësit të dinë si t'i vlerësojnë nxënësit që nuk janë përgatitur për ndonjë shkak të arsyeshem, dhe si ata që nuk e kanë kuptuar mësimin mirë.

Mësimdhënësit duhet të bëjnë vlerësim të vazhdueshëm dhe të tregojnë tolerancë ndaj nxënësve, sepse vlerësimi me notë negative i shtyn ata të ikin nga orët apo të mungojnë në ndonjë

orë dhe të krijojnë përshtypje jo të mirë për mësimdhënësin. Dhënia e notave të dobëta ka më tepër efekt negativ sesa pozitiv dhe pikërisht nga efektet negative shkaktohet edhe ikja nga orët e mësimit, që i kushton shtrenjtë edhe nxënësit edhe mësimdhënësit, madje edhe shoqërisë në përgjithësi.

Klima e shkollës është e bazuar në modelet dhe përvojat e njerëzve me jetën shkollë dhe pasqyron normat, qëllimet, vlerat, marrëdhëniet ndërpersonale, mësimin dhe praktikën mësimore. Një klimë e qëndrueshme dhe pozitive në shkollë, nxit zhvillimin e të rinjve dhe të mësuarit për një jetë demokratike produktive dhe të kënaqshme (Zaplluzha, 2016).

Nëse mbështetemi thellësisht në pedagogjinë, didaktikën dhe në metodikën e lëndës mësimore, nuk mund të fajësojmë krejtësisht mësimdhënësit, pasi shtrohet pyetja se sa ka punuar mësimdhënësi individualisht me ata nxënës, qoftë në edukimin dhe përmirësimin e tyre, qoftë për t`u sqaruar diçka që nuk e kanë të qartë apo për t`i stimuluar që të mësojnë më shumë (Ademi, 2014).

Udhëzimi administrativ lidhur me kodin e mirësjelljes në shkollë, i hartuar si i „butë”, në krahasim me dukurinë e mungesës së nxënësve në shkollë, mund të mos e ketë ndikimin e duhur në eliminimin apo reduktimin e mungesave. Mosunifikimi i rregulloreve për ndëshkim nëpër shkollat e Kosovës ka shkaktuar një liri veprimi nga ana e nxënësve, të cilën ata e shfrytëzojnë sipas qejfit të tyre.

2. 8. Përjashtimi e nxënësve nga orët mësimore

Problem më vete, në shkolla, mbetet largimi ose përjashtimi i nxënësve nga mësimi, për arsye të ndryshme. Kjo, në disa shkolla, te një numër i mësimdhënësve, tashmë ka kaluar në shprehi dhe ndërlihet pikërisht me menaxhimin e klasës, përgatitjen e mësimdhënësve për orën mësimore dhe mënyrën e komunikimit mësimdhënës-nxënës gjatë orës së mësimit. Mësimdhënësit që nuk arrijnë të menaxhojnë me kujdes orën mësimore i nxjerrin nxënësit nga mësimi, ngase nuk dinë ta menaxhojnë si duhet orën dhe nuk arrijnë t'i përfshijnë të gjithë nxënësit në mësim. Sipas profesor Musait, „Menaxhimi i mësimit ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla të të nxënësve, duke synuar që të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësve në mësim” (Musai, 2003).

Mësimdhënësit i largojnë nga orët e mësimit nxënësit që e prishin rendin dhe disiplinën në klasë dhe, të cilët, me sjelljet e tyre, i pengojnë nxënësit e tjerë të përqendrohen në procesin mësimor. Nxënësit e këtyre nuk kanë asnjë interes për të mësuar, por vijnë në shkollë thjesht të kalojnë kohën dhe të argëtohen me shoqëri. Prandaj, sjellja e mësimdhënësve në klasë, në raport me nxënësit, ka rëndësi të madhe, ngase qasja e tyre ndikon drejtpërdrejt në motivimin e nxënësve për mësim.

Qëndrimi i afërt dhe i ngrohtë i mësimdhënësve ndikon në vijueshmërinë e mësimit me rregull dhe në suksesin e përgjithshëm në mësimdhënie, kurse motivimi jo i mjaftueshëm i nxënësve nga ana e mësimdhënësve ndikon drejtpërdrejt në angazhimin, përkatësisht në mosangazhimin e nxënësve për mësim ose, thënë më ndryshe ndikon dukshëm në humbjen e interesimit të nxënësve për t'u angazhuar në procesin mësimor.

Një mësimdhënës jo motivues, impulsiv, apo me qëndrime të ashpra ndaj nxënësve, krijon klimë jo të përshtatshme në klasë, demotivim dhe neglizhencë të nxënësve ndaj procesit mësimor.

Kur mësimdhënësi arrin të ndërtojë autoritet të pakontestueshëm profesional, qëndrim të formuar etik, si dhe të dëshmojë përgjegjshmëri profesionale dhe korrektësi ndaj nxënësve, atëherë pa dyshim se arrin edhe realizim të suksesshëm të mësimdhënies. Ndërsa, mosarritja e apo mosrealizimi i këtyre kriterëve ndikon në humbjen e interesimit të nxënësve për t'u angazhuar në masën e duhur për mësim. Interesimi i nxënësve për mësim shtohet nëpërmjet komunikimit të qëndrueshëm, konstruktiv dhe të rregullt ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve, prandaj mësimdhënësit duhet t'u qasen nxënësve në mënyrë të qetë e të kujdesshme dhe të ndërtojnë raporte të shëndosha nxënës-mësimdhënës.

2. 9. Legjislacioni

Raportet e Drejtorive Komunale të Arsimit dhe të shkollave japin shifra të larta të braktisjes së orëve të mësimi, të cilat duhet t'i detyrojnë autoritetet arsimore të marrin masa shtrënguese për të frenuar braktisjen e orëve të mësimi, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Ligji për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ (UA) - Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta, Udhëzimi administrativ - Kodi i etikës për vlerësimin e nxënësve, Udhëzimi Administrativ

- Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, Plani kombëtar i veprimit kundër braktisjes 2009-2014, etj., përcaktojnë të drejtat, obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim, masat dhe proceduarat disiplinore dhe zbatimin e tyre ndaj nxënësve, të cilët i shkelin rregullat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Udhëzimi administrativ - Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta, përcakton qartë obligimet e nxënësve disa prej të cilave janë:

- Të vijojnë mësimin sipas orarit të përcaktuar nga institucionet;
- Nxënësve u ndalohet mungesa e paarsyeshme dhe hyrja me vonesë në orë të mësimi.
- Të arsyetojnë mungesat në kohën e duhur;

Nxënësit që mungon pa arsye 15 orë mësimi i thyhet nota e sjelljes në 3, ndërsa nxënësit që mungon 25 orë mësimi i thyhet nota e sjelljes në 1.

Nxënësi që mungon pa arsye më shumë se 32 orë mësimi pezullohet përkohësisht një deri në tre muaj nga procesi mësimor dhe transferohet në një shkollë tjetër.

Pezullimi më shumë se një muaj i shqiptohet nxënësit që nuk është përmirësuar, pasi ka marrë vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, pezullim nga garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet, pezullim për tri ditë dhe pezullim prej një muaji.

Masën e pezullimit, më shumë se një muaj, për nxënësit e aprovon Kuvendi Komunal, pas propozimeve të ardhura nga Drejtoria e Arsimit.

Në kornizën e politikave arsimore në Kosovë, në nivel kombëtar dhe lokal, nuk ka rregullore apo politika për mungesat në shkolla dhe kjo ka ndikuar që në asnjë dokument të rregullave të sjelljes në shkollë të miratuara nga DKA-të të mos jenë të përcaktuara qartë kriteret kur një nxënës bën mungesa të arsyeshme dhe të paarsyeshme dhe, për pasojë, në shkolla nuk ka një harmonizim se kur duhet të arsyetohen ose nuk duhet të arsyetohen mungesat e nxënësve (Devetaku-Gojani & Mehmeti, 2014).

Me rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta, shkeljet e rregullave, masat disiplinore, procedurat për vërtetimin e përgjegjësisë së nxënësve, e drejta për ankesë, përgjegjësia materiale për dëmin e shkaktuar në hapësirat shkollore, si dhe dispozitat e tjera. Shkollat janë të obliguara, që në fillim të vitit shkollor t'i njoftojnë nxënësit me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara me rregullore dhe zbatimin e saj. Nxënësit njoftohen kohë pas kohe edhe përmes kujdestarëve të klasave se e humbin të drejtën që të marrin pjesë në aktivitete jashtëkurrikulare dhe bëhet transferimi nga një paralele në një paralele tjetër, si masa më të lehta ndëshkuese.

Në disa shkolla është tejkaluar numri i mungesave të parapara me rregullore, megjithatë nxënësit nuk janë suspenduar dhe kjo dukuri vazhdon të përcillet nga viti në vit, pa mundur të gjendet zgjidhje e pranueshme, në të mirë të nxënësve dhe të procesit mësimor në përgjithësi.

2. 10. Sanksionet

Mosrespektimi i ligjit për vijimin e mësimit imponon zbatimin e masave sanksionuese. Autoritetet e arsimit bëjnë me dije se ashpërsimi i këtyre masave është e vetmja formë që mund të ndalë largimet e nxënësve nga orët e mësimit, megjithëse masat e ndërmarra disiplinore apo ndëshkuese ndaj nxënësve që mungojnë në mësim shpeshherë nuk janë treguar të suksesshme.

Sanksionet dhe dënimet ndryshojnë varësisht nga kohëzgjatja dhe shpeshtësia e mungesave të pajustificuara. Drejtori i shkollës mund të vendosë për të ndëshkuar nxënësin që mungon një ose më shumë ditë „me përfshirje“, në vend se ta përjashtojë, sepse kjo do të ndikonte edhe më shumë në largimin e tij nga shkolla.

Një nxënës „i përfshirë“ në një ditë supozon praninë dhe ndihmën e një të rrituri, në mënyrë që të sigurohet një monitorim i vazhdueshëm, por edhe mbështetje arsimore për ta ndihmuar atë në punën e tij. Çdo sanksion duhet të shpjegohet, justifikohet dhe shqiptohet varësisht nga nxënësi dhe veçoritë e tij. „Çdo sanksion i shqiptuar, duhet të jetë një sanksion i sqaruar. Të ndërmarrësh masa pa qenë i sigurt se ato janë kuptuar, kjo është thjesht, mizore“ (Prairat, 1999).

Me rastin e shqiptimit të sanksioneve ndaj nxënësve, për analizën e shkaqeve të mungesës dhe vlerësimin e situatës, mund të angazhohet shërbimi profesional. Ai shqyrton nëse masat mbështetëse të ndërmarra ndaj nxënësit janë në përputhje me personalitetin e tij. Kur e kërkon nevoja, ai u dërgon një paralajmërim atyre që janë përgjegjës për fëmijën përmes të cilit u kujton atyre obligimet ligjore dhe sanksionet penale e administrative.

Dënimet që u shqiptohen nxënësve të cilët bëjnë mungesa, mund të jenë kryesisht masa edukative, p. sh. mbajtja në orë të mësimi edhe kur përfundon orari, apo mësim plotësues. Në situatat më të rënda, i shqiptohet vërejtja si masë arsimore. Në të gjitha rastet, përjashtimi, qoftë edhe përkohësisht, hidhet poshtë, sepse ai vetëm sa do të rrisë rrezikun e dështimit të shkollës.

Pezullimi për shkak të problemeve të sjelljes është nganjëherë masë e nevojshme që përdoret në shkolla. Për fat të keq, kjo masë ka efektin e rritjes së marginalizimit të nxënësit. Nxënësi i suspenduar, pas kthimit në shkollë do ta ketë të vështirë ta ndryshojë imazhin që ka shkolla për të. Kjo mund të prodhojë në marrëdhënien nxënës-mësimdhënës ose nxënës-drejtor një efekt negativ që del nga pasojat e problemeve të sjelljes së nxënësit.

Është e mundur që për personelin e shkollës të jetë „e dëshirueshme" që nxënësi të mungojë duke pasur parasysh problemet që shkakton kur ai është i pranishëm në shkollë. Nxënësi mund ta perceptojë këtë ndjenjë edhe pse ajo nuk përmendet drejtpërdrejt. Ky qëndrim i të rriturve, e madje edhe i bashkëmoshatarëve, mund të rezultojë me dëshirën për të vazhduar ose përforcuar të munguarit e nxënësit (CTREQ, 2007).

Krahas nxënësve edhe prindërit do të duhej të ndëshkohen me gjorbë në rast se do ta neglizhonin dërgimin e fëmijëve në shkollë. Kur sanksioni u adresohet prindërve, ai merr një tjetër kuptim. Nuk është fjala më për të ndëshkuar veprimin e një nxënësi, por për të ndëshkuar prindërit apo personat përgjegjës për të. Për Pierref, fajtorë janë prindërit. „Ky sanksion u shqiptohet atyre me qëllim që t'i shtyjnë fëmijët e tyre të punojnë! Presioni i vënë në financa, nëpërmjet ndalimit të përfitimeve është një mënyrë e mirë për t'i përfshirë prindërit e nxënësve" (Saulnier, 2010)".

Edhe pse kjo dispozitë është legjitime, ndikimi i saj simbolik mund të jetë katastrofik nga pikëpamja e familjes, sidomos për familjet e varfra, që përveç gjendjes së vështirë ekonomike ballafaqohen me situata të pakëndshme nga gjykimi i të tjerëve. Ndonjëherë prindërit dhe fëmijët ndihen të poshtëruar nga sanksionimi që u bëhet. Kontakti me punonjësit socialë jashtë shkollës apriori konsiderohet si diçka e pakëndshme, e madje edhe poshtëruese për ato familje të cilat e shohin veprimin e këtyre profesionistëve si një pushtet që ndërhyjnë në jetën e tyre private. Heqja e shtesave familjare në disa raste shkakton ankthin e familjeve të varfra financiarisht dhe përkeqëson gjendjen e nxënësit.

Kur, pas të gjitha përpjekjeve për rehabilitimin dhe dialogut me familjet dhe pavarësisht kësaj mbështetjeje, personat përgjegjës për fëmijën nuk i kanë bërë të gjitha përpjekjet për të përmirësuar vijimin e nxënësit, aplikimi i sanksioneve administrative siç është pezullimi apo ndalimi i përfitimeve familjare, apo edhe i sanksioneve penale, është mjeti i fundit për t'i dhënë fund kësaj situatë me mungesa të vazhdueshme. Është fjala për rastet kur, gjatë të njëjtit vit shkollor, nxënësi bën mungesa të shumta pa arsye, pavarësisht nga paralajmërimi i shkollës drejtuar familjes.

Masat represive mund të aplikohen vetëm pas zbatimit të të gjitha përpjekjeve për të ndihmuar nga institucioni. Dënimi duhet të zbatohet vetëm për ato familje që në mënyrë eksplicite refuzojnë rëndësinë e arsimit të detyruar dhe çdo propozim për mbështetje në ushtrimin e autoritetit të tyre prindëror (Manca, 2004).

Sanksioni me dënimin me kusht nuk është zgjidhja e duhur. Sanksionet për prindërit nuk i sjellin fëmijët në bankat e shkollës,

por forcojnë edhe më tepër marginalizimin e familjeve. Në përgjithësi, dialogut në mes të komunitetit arsimor dhe prindërve në nivel shkolle është mjeti që duhet dhënë përparësi, në këto raste.

2. 11 Përvojat ndërkombëtare dhe masat e ndërmarra

Çelësi i suksesit për vijueshmërinë e mësimit me rregull nga ana e nxënësve dhe numri i vogël i mungesave në orët mësimore në shumë vende janë zbatimi i legjislacionit dhe komunikimi i rregullt me prindër. Për dallim nga Kosova, në Zvicër p. sh. , mungesat e nxënësve në procesin mësimor janë shumë më të rralla. Nxënësit e dinë se janë të obliguar të shkojnë në shkollë dhe rrallë ndodh të mungojnë në procesin mësimor, të vonohen në orën e parë ose të ikin nga orët. Këto ndodhin vetëm kur kanë ndonjë arsye, shëndetësore apo tjetër. Në këto raste, menjëherë njoftohet kujdestari i klasës ose personi përgjegjës nga mësimdhënësi i lëndës dhe po ashtu informohet edhe prindi që nxënësi nuk ndodhet në shkollë.

Nxjerrja e nxënësve që janë më problematikë, apo që nuk janë mjaft të interesuar për mësim, nga orët e mësimit për ndonjë arsye, si prishja e rendit dhe qetësisë në klasë, ndodh shumë rrallë. Megjithatë, nxënësit që nxirren nga ora e mësimit nuk lejohen të dalin jashtë objektit të shkollës, por mbahen brenda objektit të shkollës dhe këta nxënës thirren në drejtori nga kujdestari i klasës dhe drejtori dhe bisedohet me ta, në mënyrë që të mos përsëritet një gabim i tillë që mësimdhënësit të detyrohen t'i nxjerrin jashtë klasës. Po ashtu, kontaktohet edhe prindi dhe njoftohet për

problemin e shkaktuar nga fëmija i tij, me rastin e thyerjes së rregullave dhe prishjes së rendit dhe disiplinës në klasë.

Ligjet apo aktet e tjera ligjore që rregullojnë vijueshmërinë e nxënësve në shkollë u shpërndahen prindërve dhe të gjithë janë të obliguar t'u përmbahen këtyre ligjeve. Komunikimi me prindër funksionon mjaft mirë. Bisedohet me ta sipas nevojës, me disa më shpesh, dhe jo vetëm gjatë takimeve të rregullta. Çdo gjë është e rregulluar me ligj dhe kontakti i vazhdueshëm me prindër mundëson zbatimin e legjislacionit, ngase prindërit janë të njoftuar për çdo gjë që ndodh në shkollën që fëmijët e tyre e vijnë në mësim dhe janë pjesë e vendimmarrjes. Si rezultat i kësaj, mungesat e nxënësve në procesin mësimor janë mjaft të rralla, e po ashtu edhe braktisja e mësimi është mjaft e vogël¹.

Në Shqipëri, bazuar në literaturë dhe raportet e ndryshme, fenomeni i lënies së orës së mësimi mbetet ende i ndjeshëm në institucionet arsimore publike. Nxënësi i shkollës së mesme të lartë që mungon pa arsye 30 orë mësimi, paralajmërohet me shkrim nga drejtori i shkollës për përjashtim nga shkolla. Nëse mungon pa arsye edhe 15 orë të tjera mësimore, përjashtohet nga shkolla për atë vit shkollor dhe, për këtë, njoftohen prindërit i tij. Numri i mungesave është kthyer në problem madhor për mësuesit dhe prindërit, ngase nxënësit janë të gatshëm të braktisin mësimin herë pas here, me arsye dhe pa arsye, dhe për numrin e lartë të mungesave nuk ka funksionuar as njoftimi i prindërve. Braktisja e orëve të mësimi shoqërohet edhe me pasojat negative të vetë individit. Prandaj, mekanizmat për uljen e mungesave në orët e mësimi janë nga më të ndryshmet. Që në orën e parë prindi

¹ Intervistë me drejtorët e shkollave, gjatë vizitës, në qytetin e Oftringenit, Zvicër, 2016

njoftohet dhe kur bëhet një sasi mungesash vetëm ai mund të vijë dhe ta fusë në mësim fëmijën e tij. Kjo tregon që mungesa ka qenë e justifikuar ose për arsye të ndryshme mund të justifikohet.

Mungesat e nxënësit janë të arsyeshme kur justifikohen me raport mjekësor ose prindi ka kërkuar leje paraprakisht dhe më pas ka paraqitur një shënim sqarues. Prindi e paraqet arsyetimin për mungesat e fëmijës së tij te mësuesi kujdestar. Mësuesi kujdestar ka të drejtë të vlerësojë si të arsyeshme ose të paarsyeshme mungesat deri në dy ditë gjatë një muaji. Për mungesa më të gjata se dy ditë vlerësimi bëhet me shkrim nga drejtori ose zëvendësdrejtori i shkollës dhe i dorëzohet mësuesit kujdestar. Brenda javës së parë të çdo muaji, mësuesi kujdestar i dorëzon drejtorit të shkollës tabelën e mungesave mujore të klasës, të ndara në: të arsyeshme dhe të paarsyeshme, si dhe në mungesa 1-3 orësh. Drejtori, më pas, përpilon tabelën e të dhënave mujore të shkollës dhe rendit klasat sipas dy treguesve. Drejtorja e shkollës zhvillon mbledhje të posaçme për mungesat e nxënësve në tërësi ose për klasa të veçanta, sipas shumës së mungesave. (Basha, 2015).

Një mësues në Lezhë është arrestuar për shpërdorim detyre, pasi nuk i kishte vendosur një nxënësi mungesa gjatë orëve të mësimin. Policia e Lezhës thotë se mësuesi prej dy muajsh nuk i kishte vendosur mungesa nxënësit 17-vjeçar, edhe pse ky i fundit ishte jashtë vendit. Sipas regjistrit të shkollës, 17-vjeçari figuronte sikur frekuentonte rregullisht mësimin, ndërkohë që prej rreth 60 ditë, ai nuk ka qenë prezent në mësim. Ndaj mësuesit u ngrit akuza e shpërdorimit të detyrës dhe materialet i kaluan Prokurorisë së rrethit („Bota Sot”, 2016).

Raportet e hulumtimeve tregojnë se nuk ka ndonjë zvogëlim të numrit të mungesave në orët e mësimit. Problemet janë pothuajse të njëjta dhe faktorët ndikues për numrin e mungesave dhe ikjeve nga orët janë përafërsisht të njëjtë.

Në shumë vende të tjera të botës, të cilat përballen me problemin e mungesave të nxënësve në procesin mësues, janë hartuar programe dhe strategji të ndryshme dhe janë marrë masa të nevojshme për zvogëlimin e numrit të mungesave dhe parandalimin e braktisjes së shkollës.

Për shembull, programi *'Foyer' (shkolla Chomedey Quebec)* zbatohet për nxënësit e një shkolle të mesme në Chomedey që janë në rrezik të braktisjes. Programi ka për qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës duke i mbajtur nxënësit që janë në rrezik, nëse është e mundur në klasat e rregullta, si dhe t'u mundësojë mësimdhënësve në klasat e rregullta të rrisin cilësinë e mësimdhënies së tyre.

Mbështetje parandaluese, strehim për nxënësit në rrezik të braktisjes, strehim për nxënësit që kanë braktisur shkollën, për nxënësit që paraqesin sjellje shqetësuese, për nxënësit e dëbuar dhe strehim për nxënësit që shqetësojnë të tjerët, janë veprimet (masat) e ndërmarra nga programi për të luftuar braktisjen (Bouchard, 1999).

Dështimet, krizat dhe konfliktet, mund t'i shtyjnë disa nxënës të largohen nga shkolla. Nxënësit e tillë me probleme të shumta në konsultim me mësimdhënësit dhe prindërit kalojnë në këtë program. Nxënësi mund të riintegrohet me klasë të rregullt edhe gjatë vitit shkollor, përndryshe, një vit më pas, ai fillon vitin në klasë të rregullt. Ky program është për disa, e vetmja mënyrë për t'u kthyer në shkollë apo në klasat e rregullta (CTREQ, 2007).

Programi *'Kontrollo & Lidhu' (American)*, ka për qëllim të reduktojë mungesat pa arsye. Programi është ofruar për të gjitha nivelet e shkollimit.

Strategjitë që janë zbatuar për të realizuar këtë projekt janë:

- Krijimi i marrëdhënies (besimi i ndërsjellë dhe komunikimi i hapur);
- Mbikëqyrja e treguesve personalë të nxënësve, si performancën shkollore dhe sjelljen e tyre;
- Ndërhyrja individuale në përputhje me nevojat e të rinjve,
- Angazhimi për programin afatgjatë për nxënësit dhe familjet e tyre;
- Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria;
- Përmirësimi i zgjidhjes së problemeve;
- Lehtësimi i qasjes së nxënësve në aktivitete.

Roli i mësimeve është të lehtësojnë lidhjen nxënës-shkollë. Mësuesi mundëson që të zgjerojë shërbimet e shkollës dhe t'u ofrojë ato shërbime nxënësve dhe familjeve të tyre. Pastaj ai bën ndërhyrje të individualizuara me nxënësit për të ndihmuar ata që të zhvillojnë aftësitë për të mësuar dhe për të lehtësuar angazhimin e tyre drejt suksesit.

Ndërhyrjet janë dy llojesh: a) *ndërhyrja themelore* (ofrohet për të gjithë nxënësit e përmendur) dhe b) ndërhyrja intensive (e cila bëhet në bazë të nevojave individuale).

Ndërhyrja themelore ofron masa parandaluese për të gjithë nxënësit e përfshirë. Temat e takimeve mund të jenë të ndryshme si, rëndësia e qëndrimit në shkollë, zgjidhja e problemeve, etj.

Ndërhyrja intensive ka më shumë në vëmendje nxënësit që janë në rrezik të largohen nga shkolla. Shërbimet përdoren për të ndërhyrë sa më shpejt të jetë e mundur.

Për të mbajtur lidhjen familje-shkollë, bëhen rregullisht telefonata në shtëpi e po ashtu edhe mbahen takime të shpeshta. Qëllimi kryesor i punës me prindërit është të rritet pjesëmarrja e të rinjve në procesin e shkollës dhe të krijohet një marrëdhënie besimi mes shkollës dhe familjes.

Programi i kontrollit të mungesave në shkollë (Francë) trajton dhe nxit pjesëmarrjen në shkollë. Shkolla është vendi për parandalimin, identifikimin dhe trajtimin e mungesave. Për çdo nxënës që mungon nga mësimi bëhet një dosje individuale e cila përmban të dhënat e mungesave, kontaktet familjare dhe kërkesat e bëra për të rivendosur vijimin CTREQ, 2007).

Kur një nxënës mungon nga klasa, familja informohet sa më shpejt që është e mundur dhe ftohet për të dhënë arsyet e mungesës. Arsyet e identifikuara nga ana e familjes duhet të analizohen në intervistat me nxënësin. Së pari, ekipi arsimor mund të ndërveprojë (bisedojë) me familjen në lidhje me problemet e ndjekjes së shkollës dhe masat e marra për të korrigjuar ato. Së dyti, një vështrim i rregullt lidhur me mungesat, duhet të bëhet nga drejtori i institucionit. Ky vështrim do të vlerësojë dhe do të propozojë zgjidhje pedagogjike dhe arsimore.

Familja thirret në intervistë dhe informohet me obligimet ligjore, sanksionet penale dhe propozimet për të rivendosur frekuentimin. Dosja pastaj do të përcillet në zyrën e jetës shkollore dhe të shërbimit social.

Në Angli masat e pezullimit të përfitimeve sociale nuk janë efektive për kthimin e nxënësve në shkollë dhe mbajtjen e tyre aty. Në Mbretërinë e Bashkuar, politikat me fleksibilitetin më të madh në zbatimin e programeve kanë pasur rezultate pozitive (CTREQ, 2007).

Për të arritur këtë qëllim, dënimi duhet të jetë një formë edukative sanksionuese. Që nga viti 2012, qyteti anglez i Amesbury, në Wiltshire, vendosi të krijojë një partneritet në mes të shkollave dhe policisë për të luftuar kundër mungesave të nxënësve në territorin e tij. Çdo mëngjes, shkollat pajisin oficerët e policisë me listën e nxënësve që mungojnë pa arsye dhe policët pastaj shkojnë në shtëpinë e nxënësit dhe nëse nxënësi nuk ka arsye të madhe vetë e sjellin në shkollë.

Prindërit ndërkohë përballen me gjoba. Prindërit, fëmijët e të cilëve mungojnë në shkollë për më shumë se pesë ditë, pa arsye, mund të gjobiten me 60 paund (75 euro). Kjo shumë dyfishohet në qoftë se kjo nuk zgjidhet brenda 21 ditësh. Rreth 64,000 gjoba janë shqiptuar gjatë vitit shkollor 2013-2014. Ata gjithashtu mund të dënohen edhe me burgim. Në vitin 2006, një çift i Newport (Wales) është dënuar me katër muaj burg për arsye se ata nuk e kanë siguruar udhëtimin e vajzës së tyre në shkollë. Me këto masa autoritetet britanike kanë për qëllim të luftojnë kundër sjelljeve të kualifikuara si „antisociale“ të të rinjve, të cilët bëjnë mungesa pa arsye (Le puple, 2015).

Mungesat e shumta në shkollë mund ta çojnë një prind të një nxënësi në burg. Një nënë u dënua me katër muaj burg me kusht për mungesat e përsëritura të djalit të saj në klasë. Simoni „pothuajse kurrë nuk erdhi në kolegji“ gjatë vitit shkollor 2012-2013, shprehet drejtori i kolegjit të Escaudain në veri (Francë). Ai

kishte përsëritur klasën një vit më pas, pasi kishte munguar 79 gjysmëditë, në tremujorin e parë.

Gjykata është zgjidhja e fundit e institucionit arsimor kur prindërit refuzojnë dialogun. Sipas prokurorit, nëna e një nxënësi ka refuzuar çdo kontakt me Ministrinë e Arsimit. Nuk mori pjesë në punëtorinë për prindër, nuk i ndoqi udhëzimet e shërbimeve arsimore të autorizuara nga një gjyqtar i gjykatës për të mitur, dhe në fund nuk mori pjesë në gjyqin e tij. Një dënim, për një rast të ngjashëm, kishte ndodhur, në maj të vitit 2010, me një dënim prej dy muaj burg me kusht nga gjykata penale në Laon, në Aisne (Le progress, 2015).

2. 13. Përvojat vendore dhe masat e ndërmarra

Para se të bëhet hulumtimi në terren, janë mbledhur dhe analizuar materiale të shumta, si ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret e ndryshme që rregullojnë vijueshmërinë e nxënësve në procesin mësimor, për të kuptuar se si është rregulluar vijueshmëria e mësimimit nga ana e nxënësve dhe cilat janë masat që mund të ndërmerren kur nxënësit mungojnë pa arsye në procesin mësimor, te ne.

Braktisja e shkollës është një nga problematikat e arsimit parauniversitar në Kosovë dhe ky është fenomen shqetësues, i cili po përcillet nga viti në vit. Mungesat e shumta të nxënësve në orët e mësimimit paraqesin rrezik permanent për ndërprerjen e mësimimit nga ana e nxënësve. Ato janë shenja të braktisjes së mësimimit nga një numër i nxënësve. Disa nga karakteristikat e fëmijëve që janë të prirë të braktisin shkollimin janë: ikjet nga orët e mësimimit,

mungesat e shumta, vonesat në mësim dhe arsyetimet e pabazuara në fakte, etj. (Deva - Zuna, 2009).

Tashmë është nxjerrë Udhëzimi administrativ për themelimin e ekipeve për të parandaluar braktisjen e shkollës, EPRBM, të cilat u kushtojnë vëmendje fëmijëve që janë në rrezik të braktisin shkollën. Në përgjithësi, këta janë fëmijë që mungojnë shpesh nga shkolla, ndonjëherë për periudha të gjata kohore, për shkak të sëmundjes, udhëtimit ose arsyeve të tjera. (MAShT, 2014).

Mungesat e nxënësve në orët e mësimi janë të shumta. Numri i tyre arrin mbi 300 mijë për gjysmë vjetor. Raporti i Drejtorisë së Arsimit në Prishtinë, për vitin shkollor 2015/2016, ka nxjerr në pah se në shkollat e kryeqytetit, për një vit, në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit i kanë bërë afro 600 mijë mungesa. Ky raport ka dalë i njëjtë me vitin paraprak („Koha ditore”, 2016).

Çdo vit numri i mungesave të paarsyeshme është më i madh se numri i mungesave me arsye, edhe pse arsyet në të shumtën e rasteve nuk kanë bazë. Në vitin shkollor 2005/06, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, klasat 10-12, nga numri i tërësishëm i mungesave 48.1% (439,626) ishin të arsyeshme, kurse 51.9% (475,297) të paarsyeshme. Nga kjo shihet se në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, klasat 10-12, për dallim me dy nivelet e tjera, ka rritje të konsiderueshme të mungesave të paarsyeshme. (Treguesit dhe të dhënat statistikore në arsim, MAShT, 2008).

Nëse e shikojmë këtë çështje në nivel të vendit, atëherë është e vështirë të dihet saktë numri i mungesave të paarsyeshme të nxënësve në shkolla, ngase jo të gjitha shkollat i respektojnë me përpikëri rregulloret dhe aktet e tjera normative që rregullojnë vijueshmërinë e nxënësve në mësim. Edhe pse DKA-të pranojnë nga shkollat dy herë në vit raporte që lidhen me mungesat e

nxënësve, ne nuk gjetëm ndonjë dëshmi në formë të raportit të shkruar për analizën e bërë lidhur me shkaqet e mungesave, diskutimet dhe masat e ndërmarra për zvogëlimin e tyre përmes formave të ndryshme që mund të aplikohen, varësisht nga specifikat e shkollave (Devetaku-Gojani & Mehmeti, 2014).

Numri i madh i mungesave reflektohet edhe në cilësinë e mësimit, ngase nuk mund të pritet rritje e cilësisë në ato shkolla ku numri i mungesave, shpeshësia e ikjeve të nxënësve nga orët e mësimit dhe përjashtimi i nxënësve nga orët e mësimit është në rritje dhe aktorët përgjegjës nuk fillojnë të merren më seriozisht me këtë problematikë mjaft shqetësuese dhe sfiduese për ngritjen e cilësisë në arsim.

Ligjet aktuale dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tyre, përmbajnë rregulla të qarta dhe të obligueshme, të cilat parashohin obligimet që institucionet e arsimit dhe edukimit duhet t'i përmbushin.

Në shumicën e shkollave mungojnë planet operative për ndërmarrjen e masave parandaluese dhe intervenuese. Masat e ndërmarra, deri më tani, nga shkollat dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit ndaj nxënësve që e kanë tejkaluar numrin e lejuar të mungesave pa arsye lënë shumë për të dëshiruar, me disa përjashtime në disa komuna, në të cilat janë marrë vendime që disa nxënës të pezullohen nga mësimi.

Asambleja Komunale e Drenasit ka marrë vendim që 44 nxënës, nga dy shkolla të mesme të kësaj komune, të pezullohen nga mësimi. Propozimi ka ardhur nga drejtoritë e dy shkollave, ndërsa është aprovuar edhe nga Drejtoria e Arsimit dhe me shumicë votash është vendosur që këta nxënës të pezullohen nga mësimi. Para se të merret vendimi, nxënësve u është tërhequr vërejtja me

kohë, kur ata i kanë pasur vetëm nga 15 mungesa dhe kur u është thyer nota e sjelljes. Po ashtu, janë njoftuar edhe prindërit e tyre, por këta nxënës nuk janë përmirësuar, e për këtë, me kërkesën e Drejtorisë së Arsimit, Kuvendi Komunal ka marrë vendim që të pezullohen nga shkolla në kohë prej një viti. Atyre, sipas zyrtarëve për mësim në DKA, vazhdimisht u është tërhequr vërejtja se me mbi 25 mungesa të paarsyetuara do të përjashtohen nga shkolla. Pas kësaj, nxënësve u është mundësuar, t'i ndjekin mësimet joformale dhe ka pasur interesim nga disa prej tyre (Gazeta „Jeta në Kosovë”).

Përjashtime të nxënësve nga shkollat, për shkak të tejkalimit të mungesave të lejuara, ka pasur edhe në disa komuna të tjera, ndonëse në numër më të vogël. Ka pasur raste kur nxënësit ose prindërit e tyre janë ankuar në Ministrinë e Arsimit dhe nxënësit janë kthyer në shkollë, në disa raste edhe në kundërshtim me aktet ligjore, pa i përfillur procedurat administrative dhe rregulloret në fuqi.

Shumë herë, në konferenca dhe takime të ndryshme, është ngritur ky problem dhe veçanërisht është kërkuar që të hetohen lokalet përgjatë rrugës ku ndodhen shkollat sepse ato lokale frekuentohen shumë nga nxënësit e parregullt dhe dyshohet se ata aty, mund të konsumojnë substanca narkotike, por në të shumtën rasteve gjendja ka mbetur e njëjtë, ngase organet kompetente nuk kanë ndër marrë kurrfarë masash.

III. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

3. 1 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është identifikimi dhe analiza e gjendjes aktuale të dukurisë së mungesave të nxënësve në shkolla, shkaqet dhe pasojat, si dhe veprimet që duhet të ndërmerren nga institucionet vendimmarrëse që të reduktohet numri i mungesave dhe të përmirësohet vijueshmëria e nxënësve në mësim.

3. 2. Pyetjet hulumtuese

Çështjet e ngritura në këtë hulumtim kanë të bëjnë me nivelin e mungesave të nxënësve në shkollë, shkaqet dhe pasojat e tyre, masat që duhet të ndërmerren nga institucionet vendimmarrëse si dhe ndikimin e familjes në reduktimin e mungesave. Është me rëndësi të zbulojmë ndikimin e këtyre faktorëve në përmirësimin e vijueshmërisë. Bazuar në këtë fakt, studimi është përpjekur t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve:

1. Sa shpesh nxënësit mungojnë nga orët e mësimit?
2. Cilat janë arsyet e mungesës?
3. Sa është e lartë shkalla e ikjeve nga orët e mësimit?
4. Sa është e lartë shkalla e përjashtimit të nxënësve nga mësimi nga ana e mësimdhënësve?
5. Cilat janë pasojat nga mungesat e shumta?

6. Cilat janë masat që ndërmerren shkolla ndaj nxënësve që kanë shumë mungesa?
7. Çfarë është komunikimi dhe bashkëpunimi i shkollës me prindërit për këtë çështje?

3. 3. Lloji i hulumtimit

Lloji i hulumtimit është i tipit të përzier, sasior dhe cilësor. Përmes pyetësorit morëm opinionet nga shkolla mbi numrin e mungesave, frekuencën, ikjet dhe përjashtimet e nxënësve nga orët mësimore, shkaqet dhe pasojat, si dhe masat e ndërmarra për reduktimin e tyre.

Në hulumtim, vend me rëndësi zë edhe kërkimi cilësor, me anën e të cilit studiuam perceptimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave për vijimin e rregullt të mësimin, zbatimin e ligjit dhe rregulloreve, masat e ndërmarra dhe bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes. Të dhënat cilësore janë marrë nga pyetjet e hapura të pyetësorëve për nxënës dhe mësimdhënës dhe nga intervistat gjysmë të strukturuar me drejtorët e shkollave.

3. 4. Popullacioni dhe mostra

Popullacioni i hulumtimit përbëhet nga nxënësit, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave të mesme të larta në Kosovë. Nga ky popullacion i gjerë, për të hulumtuar problemin, kemi zgjedhur mostrën e hulumtimit, në të cilën janë përfshirë 8 komuna të Kosovës, me gjithsej 16 shkolla (8 profesionale dhe 8 gjimnaze).

Mostra e nxënësve përbëhet nga gjithsej 400 nxënës të klasave të dhjeta, me nga 25 nxënës në një shkollë – të disa paraleleve, (aty

ku kishte më shumë paralele janë marrë nga 5 nxënës për paralele), kurse mostra e mësimdhënësve përbëhej nga 64 mësimdhënës, nga 4 mësimdhënës prej një shkolle, kujdestar klase apo mësimdhënës i klasave të dhjeta. Pjesë e mostrës kanë qenë edhe 16 drejtorët e shkollave të përfshira në hulumtim.

3. 5. Metodatat e hulumtimit

Për të siguruar të dhëna të mjaftueshme nga grupet e interesit, kemi përdorur këto metoda të hulumtimit:

Metodën e analizës së dokumentacionit - përmes të cilës është bërë mbledhja e të dhënave dhe analiza e ligjeve, udhëzimeve, strategjive, rregulloreve, doracakëve, raporteve të hulumtimit dhe botimeve të tjera;

Metodën e anketimit - përmes të cilës janë marrë opinionet e nxënësve, mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave.

Metodën statistikore - përmes të cilës janë shprehur në mënyrë statistikore rezultatet e dala nga hulumtimi, nxjerrja e treguesve relevantë, shprehja e të dhënave në mënyrë tabelore (grafike) dhe paraqitja e rezultateve në përqindje;

3. 6. Teknikat dhe instrumentet e hulumtimit

Mbledhja e të dhënave është bërë me teknikën e analizës së dokumentacionit dhe teknikën e punës me pyetësorë. Ndërsa, sa u përket instrumenteve, kemi përdorur protokollin e analizës së dokumentacionit, fletëpyetësorët për nxënës, mësimdhënës dhe intervistat gjysmë të strukturuar për drejtorët e shkollave.

Në hulumtim kemi përdorur si instrument kryesor pyetësoin për nxënësit dhe pyetësoin për mësimdhënësit. Pyetësoin e kemi përdorur për mbledhjen e të dhënave kryesisht sasiore. Ai është i strukturuar në disa seksione. Përveç të dhënave të përgjithshme, pyetësoi përmban pyetjet që kanë të bëjnë me frekuencën e mungesave, vonesat e nxënësve, ikjet nga orët e mësimi, nxjerrja apo largimi i tyre nga mësimi, shkaqet dhe pasojat, bashkëpunimi me prindër si dhe masat që ndërmerren shkolla për reduktimin dhe parandalimin e mungesave. Disa nga pyetjet e pyetësoit janë të njëjta si për mësimdhënësit, ashtu edhe për nxënës, me qëllim të krahasimit të opinioneve të tyre për çështje të njëjta. Pyetësoi përmban edhe pyetje të hapura, në mënyrë që nga nxënësit dhe mësimdhënësit të marrim të dhëna kontekstuale, cilësore. Me drejtorë kemi përdorur intervistën, si metodën më të njohur të kërkimit cilësor, pasi ajo ka siguruar material për analiza cilësore.

3. 7. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Në fazën e parë është bërë hulumtimi kabinetik. Janë analizuar ligjet që rregullojnë vijueshmërinë e mësimi, Udhëzimet administrative, strategjitë dhe një sërë raportesh e botimesh të tjera që ndërlidhen me vijueshmërinë e nxënësve në mësim. Po ashtu është hartuar pyetësoi dhe është bërë pilotimi i tij.

Në fazën e dytë, pas përzgjedhjes së mostrës, nga grupi i hulumtuesve është bërë hulumtimi në terren, me nxënës, mësimdhënësit dhe drejtorë të shkollave. Paraprakisht është marrë miratimi me gojë i nxënësve për plotësimin e pyetësoit.

Të dhënat janë mbledhur në shkolla dhe janë administruar nga hulumtuesit e IPK-së, ndërsa vendet për zhvillimin e intervistave

janë caktuar në bashkëpunim me drejtorët e shkollave, gjatë komunikimit me ta për caktimin e ditës dhe të orës për zhvillimin e tyre. Meqenëse intervistat janë zhvilluar në objektet shkollore, të pranishëm në mbledhjen e të dhënave kanë qenë drejtorët e shkollave.

Mësimdhënësit u anketuan në pushim mes orëve ose në pauza mes dy ndërrimeve. Intervistat e parapara me drejtorët dhe respondentët tjerë u realizuan me diktafon, me lejen paraprake të të intervistuarit. Në rastet kur i intervistuari nuk dëshironte të incizohej, intervista shënohej nga intervistuesi.

3. 8. Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave të hulumtimit është bërë me qëllim që të përshkruhen përgjigjet e nxënësve, mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave për sfidat dhe mundësitë për ndryshimin e gjendjes. Për përpunimin e të dhënave statistikore është përdorur programi *Microsoft Office Excel 2007*. Të dhënat e dala nga hulumtimi janë paraqitur në grafikone të përbashkëta për nxënës dhe mësimdhënës, për të parë dallimet dhe ngjashmëritë në përgjigjet e dhëna në të njëjtat pyetje. Ndërsa përgjigjet e drejtorëve janë paraqitur ndaras. Gjatë interpretimit kemi shpjeguar të gjeturat e hulumtimit, hapat që janë ndërmarrë deri më tani dhe sfidat me të cilat janë duke u përballur shkollat. Të dhënat cilësore, të dala nga intervistat, janë analizuar duke përdorur analizën e interpretimit dhe duke grupuar përgjigjet për çdo pyetje, të cilat pastaj janë interpretuar në mënyrë përshkuese.

IV. REZULTATET E HULUMTIMIT DHE INTERPRETIMI I TYRE

Në pjesën e parë i kemi paraqitur rezultatet e dala nga hulumtimi me nxënës dhe mësimitdhënës, ndërsa në pjesën e dytë i kemi paraqitur mendimet e drejtorëve të shkollave. Paraqitja e të dhënave paralelisht është bërë me qëllim që të krahasohen perceptimet e nxënësve dhe të mësimitdhënësve si dhe për të parë dallimet dhe ngjashmëritë në përgjigjet e tyre.

Për të kuptuar se cilat janë mundësitë e zvogëlimit të numrit të mungesave të nxënësve në orët e mësimit, numrin e ikjeve nga orët e mësimit dhe cilat janë sfidat me të cilat po përballen shkollat, nxënësit, mësimitdhënësit, drejtorët/zëvendësdrejtorët e shkollave janë pyetur se sa shpesh mungojnë apo ikin nxënësit nga orët e mësimit, në cilat orë dhe lëndë mungojnë më shpesh, cilat janë arsyet më të shpeshta që nxënësit ikin nga orët e mësimit, apo mësimitdhënësit i largojnë nga ora për ndonjë arsye, ku qëndrojnë nxënësit kur ikin nga orët e mësimit apo kur largohen nga mësimitdhënësit, si e trajtojnë shkollat këtë problem, cilat janë masat e ndërmarra, cilat janë pasojat për nxënësit që mungojnë në mësim, kush janë përgjegjësit, sa zbatohen ligjet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi dhe cilat janë sugjerimet dhe rekomandimet e aktorëve të përfshirë në hulumtim, në mënyrë që të përmirësohet sadopak gjendja në të ardhmen.

Hulumtimi ka treguar se një faktor me rëndësi në motivimin e nxënësve për orën mësimore pa dyshim që është përdorimi i teknologjisë së informimit gjatë dhe pas procesit mësimor. Mungesat e nxënësve në mësim është treguesi i mirë se përdorimi


i tekstit mësimor si burim i vetëm i të nxënësve nuk është atraktiv, andaj nxënësi nuk është i motivuar për orë mësimore.

4. 1. Rezultatet e dala nga nxënësit dhe mësimdhënësit

Qëllimisht rezultatet e nxënësve dhe mësimdhënësve i kemi paraqitur së bashku në grafikë, që të shihen dallimet dhe ngjashmëritë në përgjigjet e nxënësve dhe të mësimdhënësve lidhur me mungesat ditore, në orën e parë ose orët e fundit, ikjet nga orët dhe përjashtimi i nxënësve prej orëve nga ana e mësimdhënësve për arsye të ndryshme.


Sa u përket mungesave që bëjnë nxënësit në orën e mësimin, rezultatet e hulumtimit tregojnë se ato janë mjaft të shpeshta dhe ndodhin çdo ditë. Mungesat janë ditore apo vetëm disa orëshe, brenda ditës. Mësimdhënësit dhe vetë nxënësit kanë deklaruar se nxënësit më së shpeshti mungojnë në orën e parë të mësimin dhe në orët e fundit. Në pyetjen që u është bërë nxënësve dhe mësimdhënësve se në cilat orë të mësimin zakonisht nxënësit mungojnë më shpesh në shkollën tuaj, kemi marrë përgjigje përafërsisht të njëjta nga nxënësit dhe mësimdhënësit për orën e parë të mësimin dhe në rastet e tjera, ndërsa për orët e fundit kemi një dallim të dukshëm në përgjigje: Mbi 63 % e nxënësve kanë thënë se nxënësit zakonisht mungojnë në orën e parë të mësimin, ndërsa këtë e kanë thënë 71 % e mësimdhënësve. Që nxënësit më tepër mungojnë në orët e fundit janë deklaruar 57 % e nxënësve, për dallim nga mësimdhënësit, që vetëm 27 % e tyre kanë thënë se nxënësit zakonisht mungojnë në orët e fundit. Për opsionin e mungesave tërë ditore kemi marrë përgjigje përafërsisht të njëjta

nga nxënësit dhe mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim. (Grafiku 1).




Grafiku 1. Mungesat nga orët e mësimit

Duke e ditur se nxënësit jo të gjitha lëndët i pëlqejnë njësoj, janë pyetur edhe për lëndën në të cilën mungojnë më së shumti. E njëjta pyetje u është bërë edhe mësimdhënësve me qëllim që të krahasojmë përgjigjet e marra me ato të nxënësve. Sa i përket lëndës në të cilën nxënësit mungojnë më shpesh, kemi marrë këto përgjigje nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Përgjigjet e dhëna tregojnë se më pak të pëlqyera për nxënësit janë lëndët natyrore. Ata kanë deklaruar se në lëndën e Kimisë nxënësit mungojnë më së shumti, pasuar nga lënda e Fizikës, Matematikës etj. Ndërsa edhe mësimdhënësit kanë dhënë përgjigje pothuajse të njëjta, por për dallim nga nxënësit kanë thënë se më tepër mungojnë në lëndën e Matematikës (Grafiku 2).



Grafiku 2. Lëndët në të cilat nxënësit mungojnë më së shpeshti

Një pyetje tjetër për nxënësit dhe mësimdhënësit ka qenë se cilat janë arsyet më të shpeshta që nxënësit mungojnë në orët e mësimin. Në këtë pyetje janë dhënë përgjigje të ndryshme nga nxënësit dhe mësimdhënësit. Arsyeja kryesore sipas nxënësve është se nuk u pëlqen shkolla, ndërsa mësimdhënësit mendojnë se prindërit nuk kujdesen mjaft për fëmijët e tyre e po ashtu edhe kushtet socio-ekonomike janë arsye tjetër që i shtyjnë nxënësit të mungojnë meqë, sipas mësimdhënësve, disa prej tyre detyrohen edhe të punojnë pasi që mbesin dhe mund të llogariten si mbajtës të familjes. Arsyet e tjera janë dhënë pothuajse të njëjta nga nxënësit dhe mësimdhënësit, të cilat janë paraqitur në grafikun në vazhdim.




Grafiku 3. Arsyet e mungesave në orët e mësimt

Përveç arsyeve që janë dhënë në grafikun mësipërm, nxënësit dhe mësimdhënësit kanë dhënë edhe një sërë arsyesh të tjera pse nxënësit që mungojnë në orën e parë të mësimt, në orët e fundit, apo edhe tërë ditën. Përgjigjet më të shpeshta të nxënësve për arsye të tjera të mungesave në orët e mësimt janë: mospërgatitja për mësim dhe arsyet shëndetësore. Një numër më i vogël i nxënësve theksojnë udhëtimin dhe mospërfilljen e tyre nga ana e mësimdhënësit, si arsye për mungesë në shkollë.

Edhe mësimdhënësit kanë deklaruar se nxënësit kur nuk janë të përgatitur, nuk hyjnë fare në orën mësimore nga frika se do të marrin nota negative. Ndër arsyet tjera të mungesave, ata theksojnë arsyet shëndetësore dhe udhëtimin e nxënësve.

Për të kuptuar se a bëhen më tepër mungesa nga nxënësit në orën e mësimt sesa mungesat që janë të evidentuara në ditat, një ndër pyetjet që u është bërë nxënësve, por edhe mësimdhënësit ka qenë nëse shënohen mungesat e nxënësve që mungojnë në orët e mësimt çdoherë në ditat ose jo dhe pse? Përgjigjet e nxënësve dhe të mësimdhënësit në këtë pyetje, janë të përafërta.

Mësimdhënësit i shënojnë në ditat nxënësit që mungojnë në orët e mësimi, por jo çdoherë e bëjnë këtë dhe arsyet për këtë janë të ndryshme. Sipas nxënësve, shpesh mësimdhënësit harrojnë t'i shënojnë, nuk duan të bëhen shumë mungesa në ditat, nuk iu kushtojnë rëndësi, e dinë arsyen e mungesës, kanë marrë leje, shpresojnë se nxënësi do të kthehet, apo nuk dëshirojnë t'u shkaktojnë probleme në familje me këto mungesa, ndërsa mësimdhënësit arsyetohen se nuk ka fare ndikim evidentimi ose mos evidentimi i mungesave, pasi disa nxënës nuk brengosen aspak për numrin e tyre. Grafiku në vazhdim paraqet përgjigjet e dhëna në përqindje të nxënësve dhe mësimdhënësvë lidhur me evidentimin e mungesave në ditat.




Grafiku 4. Evidentimi i mungesave në ditat

4. 1. 1. Ikja e nxënësve nga orët e mësimi

Përveç mungesave të nxënësve në orën e parë të mësimi, apo mungesave ditore, problem tjetër, me të cilin përballen shkollat, është edhe ikja e nxënësve nga orët e mësimi për arsye të


ndryshme. Mësimdhënësit dhe nxënësit janë pyetur se a ndodh shpesh që nxënësit të ikin nga orët e mësimit dhe përsëri të kthehen në mësim, apo edhe të mos kthehen fare brenda ditës, dhe kemi marrë këto përgjigje. Më shumë se 30 % e nxënësve, të përfshirë në hulumtim, kanë deklaruar se nxënësit ikin çdo ditë nga orët e mësimit, rreth 60 % kanë thënë se ikin nganjëherë, ndërsa vetëm 4.8 % kanë thënë se nxënësit nuk ikin nga orët e mësimit. Mësimdhënësit vetëm 3 % kanë thënë se nxënësit ikin nga mësimi çdo ditë, 63 % kanë thënë nganjëherë, kurse për dallim nga nxënësit, më shumë se 33 % kanë deklaruar se nxënësit nuk ikin asnjëherë nga mësimi. (Grafiku 5).



Grafiku 5. Ikja e nxënësve nga mësimi

Arsyet pse nxënësit ikin nga orët e mësimit janë të shumta dhe konkretisht lidhen me shkollat joatraktive. Në pyetjen që u është bërë nxënësve dhe mësimdhënësvë se cilat sipas tyre janë arsyet që nxënësit ikin nga orët e mësimit, kemi marrë këto përgjigje: nuk u pëlqen lënda mësimore, nuk janë të përgatitur për orë, nuk janë të interesuar fare për mësim, nuk u pëlqen mësimdhënësi,

lodhja për shkak të orëve të shumta, nuk janë të disponuar, orët janë monotone, krentimi i ndonjë feste, ndihen jo të qetë, sjellja jo adekuate e profesorit ndaj nxënësve e të tjera. Përgjigjet e nxënësve dhe të mësimeve kanë qene përafërsisht të njëjta, me përjashtim te alternativa e parë dhe e katërt, ku nxënësit, në përqindje më të madhe, kanë thënë se nuk u pëlqejnë lënda dhe mësimeve. Arsyet më të shpeshta që kanë dhënë nxënësit dhe mësimeve, janë paraqitur në grafikun në vazhdim.




Grafiku 6. Arsyet e ikjes së nxënësve nga mësimi

4. 1. 2. Përjashtimi nxënësve prej orëve nga mësimeve

Një dukuri mjaft shqetësuese dhe goxha e theksuar në shkollat e mesme të larta vazhdon të jetë edhe përjashtimi ose largimi i nxënësve nga orët e mësimit prej mësimeve dhe kjo bëhet për disa arsye. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se disa mësimeve edhe më tutje vazhdojnë të përjshojnë nxënësit nga ora e mësimit. Kjo praktikohet nga mësimeve që shkojnë të papërgatitur në orë dhe nuk arrijnë të menaxhojnë orën si duhet. Mësimeve e tillë, i largojnë nxënësit nga ora me arsyetimin

se ata po e prishin disiplinën në klasë. Me këtë ata tregojnë paaftësinë për të gjetur forma që t'i bëjnë nxënësit pjesë të orës, duke i angazhuar dhe trajtuar të barabartë me nxënësit e tjerë brenda klasës. Në pyetjen se a ndodh ndonjëherë që mësimitdhënësit të largojnë nga ora nxënësit që nuk u përmbahen rregullave të orës mësimore dhe që e prishin disiplinën në klasë, kemi marrë këto përgjigje nga nxënësit dhe mësimitdhënësit. Në përqindje më të madhe nxënësit dhe mësimitdhënësit kanë thënë se largimi i nxënësve nga ora ndodh rrallë, kurse 24 % e nxënësve kanë thënë se kjo ndodh shpesh. 23 % të mësimitdhënësve që kanë thënë se nuk ndodh asnjëherë që nxënësit të largohen nga ora e mësimit nga ana e mësimitdhënësve (Grafiku 7).




Grafiku 7. Frekuenca e nxjerrjes së nxënësve nga orët e mësimit

Në pyetjen pse ndodh përshtimi i nxënësve nga ora e mësimit, nxënësit dhe mësimitdhënësit kanë dhënë arsye të ndryshme. Përveç prishjes së qetësisë dhe pengimit të procesit mësimor me anë të telefonave ose ngacmimit të njëri-tjetrit, ndodh që nxënësit të largohen nga ora edhe për shkak se nuk i marrin librat me vete dhe shkojnë në shkollë tërësisht të papërgatitur për orën mësimore, apo nuk i përcjellin me vëmendje aktivitetet që

zhvillohen gjatë orës së mësimit nga mësime dhënësi dhe shokët e klasës.


Shqetësues është vendqëndrimi i nxënësve që ikin nga orët e mësimit dhe që nxirren jashtë nga ana e mësime dhënësi për ndonjë arsye, pasi që ata nxënës nuk qëndrojnë në objektet e shkollës, por dalin në oborr dhe i pengojnë edhe nxënësit e tjerë duke u sjellë afër dritareve të shkollës, ose shkojnë në ndonjë kafene apo në lojëra të fatit, të cilat janë mjaft të dëmshme dhe të rrezikshme për moshën e tyre, e që në shumë raste këto lokale gjenden në afërsi të shkollës. Në pyetjen e bërë nxënësve dhe mësime dhënësi se ku qëndrojnë nxënësit që ikin nga orët e mësimit dhe kur nxirren jashtë orës nga ana e mësime dhënësi për shkak të mosrespektimit të rregullave të orës mësimore, kemi marrë këto përgjigje. Rreth 70 % e nxënësve dhe mësime dhënësi deklarojnë se nxënësit që ikin nga orët e mësimit apo nxirren jashtë nga ana e mësime dhënësi, qëndrojnë në oborrin e shkollës, kurse nëpër kafene sipas nxënësve, qëndrojnë mbi 60 % të tyre që dallon dukshëm nga përgjigjet e mësime dhënësi sipas të cilëve në kafene qëndrojnë 32 % prej tyre.



Grafiku 8. Vendqëndrimi i nxënësve të përjashtuar nga ora mësimore


Përveç lokacioneve të dhëna në grafikun e mësipërm, nxënësit dhe mësimitdhënësit në përgjigjet e tyre kanë treguar edhe vende të tjera të mundshme ku mund të qëndrojnë derisa të përfundojë ora, apo edhe derisa të përfundojë tërë procesi mësimor. Këto vende janë më pak të rrezikshme krahasuar me kafenetë dhe lojërat e fatit, por gjithsesi të dëmshme për të ardhmen e tyre dhe pengesë për një proces normal të mësimin brenda shkollës. Një numër më i madh i tyre, kur mungojnë apo nxirren nga mësimi, qëndrojnë në shtëpi apo diku në qytet, pa specifikuar ndonjë lokacion konkret. Disa nga nxënësit që mungojnë, qarkullojnë kryesisht në hapësirat e shkollës, si në bufenë e shkollës, mbrapa shkollës apo aty, diku afër saj.

Për ta kuptuar se kush janë përgjegjës kryesorë për mungesat e shumta të nxënësve në procesin mësimor, kemi pyetur nxënësit dhe mësimitdhënësit se kush, sipas tyre, janë përgjegjës për mungesat e shumta të nxënësve në orët e mësimin. Në përgjigjet e dhëna vërehet se sipas nxënësve, përgjegjës kryesorë janë prindërit dhe kujdestarët e klasës, ndërsa mësimitdhënësit në një përqindje më të madhe i fajësojnë prindërit - mbi 76 %, pasuar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, kujdestarët e klasave dhe drejtorin. (Grafiku 9).




Grafiku 9. Përgjegjësit për mungesat e nxënësve

Një ndër personat përgjegjës, i cili merret drejtpërdrejt me nxënësit që mungojnë në orët e mësimit, është kujdestari i klasës. Për të kuptuar se cili është ndikimi i tyre në këtë aspekt, kemi pyetur nxënësit dhe mësimehdhënësit se sa kanë ndikim vërejtjet e kujdestarit të klasës që nxënësit të mos bëjnë mungesa pa arsye. Lidhur me këtë, nxënësit, në përqindje më të madhe, kanë deklaruar se ndikimi i kujdestarëve të klasave është i vogël, për dallim prej mësimehdhënësve, të cilët kanë thënë se kujdestarët e klasave kanë shumë ndikim që nxënësit të bëjnë sa më pak mungesa pa arsye. Vetëm 40 % e nxënësve janë deklaruar se mësimehdhënësit kujdestarë kanë shumë ndikim te nxënësit që të mos mungojnë pa arsye, ndërsa të njëjtin mendim e kanë mbi 60 % e mësimehdhënësve të përfshirë në hulumtim. Grafiku në vazhdim paraqet përgjigjet e nxënësve dhe të mësimehdhënësve rreth ndikimit që kanë mësimehdhënësit kujdestarë në reduktimin e mungesave të nxënësve në procesin mësimor.



Grafiku 10. Ndikimi i kujdestarit të klasës në zvogëlimin e mungesave

Përveç për numrin - shpeshtësinë e mungesave, për vendin ku qëndrojnë nxënësit që nuk hynë në orë, si dhe për arsyet pse mungojnë dhe kush janë përgjegjës, nxënësit dhe mësimsdhënësit janë pyetur edhe për pasojat që kanë nxënësit nëse mungojnë shpesh në orët e mësimi. Në këtë pyetje kemi marrë përgjigje pothuajse të përafërta të nxënësve dhe të mësimsdhënëseve, që tregon se jo vetëm mësimsdhënësit, por edhe vetë nxënësit janë në dijeni për pasojat që mund të kenë në të ardhmen nëse mungojnë pa arsye dhe e tejkalojnë numrin e mungesave të lejuara me ligj ose me aktet të tjera nënligjore. (Grafiku 11).



Grafiku 11. Pasojat nga mungesat e shumta

Për ta kuptuar se çfarë kanë bërë shkollat në këtë drejtim dhe sa janë të informuar nxënësit dhe mësimsdhënësit për hapat e ndërmarra deri më tani për të zvogëluar numrin e mungesave, kemi pyetur nxënësit dhe mësimsdhënësit se cilat janë masat e ndërmarra nga shkolla ndaj nxënësve. Sa i përket kësaj pyetje, vërehen dallime në përgjigjet e nxënësve dhe mësimsdhënëseve. Përgjigjet e dhëna lënë të kuptojmë se pjesa më e madhe e nxënësve dhe mësimsdhënëseve nuk e dinë saktësisht nëse është

ndërmarrë ndonjëra prej masave të cekura me rregullore për zvogëlimin e mungesave nga nxënësit, për të cilat shkollat e kanë për detyrë sipas rregulloreve.

Sipas nxënësve, ndër masat kryesore që janë ndërmarrë nga shkolla ndaj tyre për shkak të mungesave të shumta janë suspendimi i nxënësve për një kohë të caktuar, duke filluar nga 3 ditë e pastaj varësisht nga numri i mungesave bëhet suspendimi i tyre për një kohë më të gjatë dhe parapërrjashtimi i tyre për tejkalimin e mungesave. Zbritja e notës së sjelljes është po ashtu ndër masat e shpeshta që u shqiptohen nxënësve, varësisht nga numri i mungesave, qortimi me gojë, thirrja e prindërve në shkollë nga ana e kujdestarit të klasës apo e drejtorit, dhe ndërrimi i klasës apo shkollës dhe mbetja si i pa notuar, edhe pse këto dy masat e fundit janë raste të rralla.

„Masat e ndërmarrura nuk janë efikase, sepse numri i mungesave nuk është zvogëluar, por ai vazhdimisht është në rritje. Për këtë arsye, masat ndaj nxënësve duhet të jenë shumë më të rrepta. Shkolla duhet të tregohet më e ashpër ndaj nxënësve që ikin nga orët e mësimin dhe nëse ata e përsërisin këtë, të përjashtohen menjëherë nga shkolla” – thotë një nxënës.


Edhe përgjigjet e mësimdhënësve nuk dallojnë shumë nga ato të nxënësve. Vërejtjet me gojë, vërejtjet me shkrim, suspendimi i nxënësve, varësisht nga numri i mungesave dhe ulja e notës së sjelljes sipas rregullores së shkollës dhe kodit të mirësjelljes janë masat që ndërmarrin shkollat ndaj nxënësve që mungojnë dhe që bëjnë shkelje të tjera disiplinore. Kontakti, bashkëbisedimi dhe bashkëpunimi me prindërit nga ana e kujdestarit dhe drejtorit të shkollës, aplikohen shpesh. Një numër i vogël i mësimdhënësve

kanë deklaruar se në shkollën e tyre nuk ndërmerren kurrfarë masash ndaj nxënësve që kanë mungesa përtej të gjitha limiteve.

Për implementimin e rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, janë pyetur vetëm mësimitdhënësit dhe drejtorët e shkollave. Mësimitdhënësit janë pyetur se a janë të kënaqur me implementimin e tyre, nëse jo çfarë do të ndryshonin që nxënësit të mos mungojnë në shkollë pa arsye dhe rastet e braktisjes së shkollës të jenë sa më të vogla në të ardhmen. Në përqindje më të madhe kemi marrë mendime se duhet të jenë më të rrepta masat e rregulluara me ligj, si dhe të modifikohen dhe të plotësohen ligjet dhe rregullorja e shkollës në fuqi. Edhe modifikimi dhe plotësimi i ligjeve dhe rregulloreve të shkollës përfaqësohet me një përqindje mjaft të lartë nga ana e mësimitdhënësve.

4. 1. 3. Dallimet ndërmjet shkollave profesionale dhe gjimnazeve

Pothuajse në të gjitha shkollat profesionale, të të gjitha komunave të Kosovës bëhen mungesa të shumta nga nxënësit. Një numër i madh i nxënësve vonohen në orën e parë të mësimin dhe shpesh nuk hyjnë fare në orë, apo për shkak të vonesës nuk lejohen që të hyjnë në shkollë. Po ashtu, edhe mungesat e paarsyeshme ditore, në disa shkolla, janë bukur të shpeshta. Numri i nxënësve që i kanë tejkalar numrin e lejuar të mungesave të paarsyeshme është goxha i madh, në shumicën e shkollave profesionale të përfshira në hulumtim. Grafiku në vazhdim paraqet dallimet e mungesave sipas tipit të shkollave.




Grafiku 12. Mungesat e nxënësve sipas tipit të shkollave

Edhe ikjet e nxënësve nga orët e mësimit janë mjaft të shpeshta dhe kjo sipas nxënësve dhe mësimeve të përfshirë në hulumtim ndodh për disa arsye. Ndër arsyet kryesore është mos përgatitja e mjaftueshme për orën e mësimit, mungesa e interesimit në përcjelljen e ndonjë lënde, ikjet nga orët për të shkuar në lojëra të fatit, apo lokalet që gjenden afër shkollave, etj. Meqenëse kryesisht në shkollat profesionale më tepër regjistrohen nxënësit me sukses më të dobët në shkollën e mesme të ulët, këta nxënës zakonisht janë më problematikë dhe më pak të interesuar për mësim. Prandaj, shpesh ata thyejnë rregullat dhe prishin rendin dhe disiplinën në klasë, kurse mësimeve vendosin që nxënësit e këtillë i largojnë nga ora e mësimit.

Krahasuar me shkollat profesionale, numri i mungesave në gjimnaze është dukshëm më i vogël, shpeshësia e ikjeve nga ora e mësimit është po ashtu më e vogël, e edhe përjashtimi i

nxënësve nga ora e mësimit nga ana e mësimeve në gjimnaze ndodh shumë më rrallë. Grafiku në vazhdim paraqet dallimet ndërmjet shkollave profesionale dhe gjimnazeve me përgjigjet e nxënësve dhe mësimeve për shpeshësinë e ikjes së nxënësve dhe largimin e tyre prej orës së mësimit nga mësimeve.



Grafiku 13. Shpeshësinë e ikjes së nxënësve nga orët mësimore

Ndërsa, sa u përket shkaqeve pse nxënësit mungojnë në orët e mësimit, arsyeve pse ikin nga orët dhe pse largohen nga mësimi nga ana e mësimeve janë pothuajse të njëjta edhe në gjimnaze. Po ashtu, edhe pasojat me të cilat përballen këta nxënës janë përafërsisht të ngjashme. Të njëjtë janë edhe përgjegjësit, por edhe vendqëndrimet e nxënësve që mungojnë në orët e mësimit nuk dallojnë shumë prej shkollave profesionale. Sa i përket ndikimit të kujdestarëve të klasave, trajtimit, masave që janë ndërmarrë nga shkollat, zbatimit të legjislatcionit në fuqi dhe sugjerimeve e rekomandimeve të dhëna, po ashtu, nuk ka ndonjë

dallim të madh ndërmjet shkollave profesionale dhe gjimnazeve. Pra, dallime të theksuara vërehen në numrin e mungesave, shkaku i vonesave në orën e parë, shpeshhtësisë së ikjes së nxënësve nga orët e mësimi, dhe nxjerrjes nga ora nga mësimdhënësit për arsye të ndryshme. Këto probleme janë shumë më tepër të shprehura në shkollat profesionale sesa në gjimnaze, edhe pse jo në të gjitha gjimnazet gjendja e mungesave është e kënaqshme.

4. 1. 4. Propozimet dhe sugjerimet e nxënësve dhe të mësimdhënësve

Nga nxënësit dhe mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim është kërkuar që duke u bazuar në rastet me të cilat janë përballur shkollat e tyre, të japin sugjerimet e tyre, si dhe të propozojnë masat që ata mendojnë se do të duhej të ndërmerren shkollat dhe institucionet e tjera përgjegjëse për ndryshim e gjendjes në të ardhmen. Shumica e propozimeve dhe sugjerimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve për hapat që do të duhej të ndërmerreshin ndërlidhen me legjislacionin në fuqi, përmes të cilit do të duhej të fuqizohej trekëndëshi nxënës-mësimdhënës-prind, si kusht për përmirësimin e vijueshmërisë së shkollimit me rregull nga ana e nxënësve.

Numri më i madh i sugjerimeve (propozimeve) kanë të bëjnë me përcjelljen e vazhdueshme të gjendjes, respektimin ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, rritjen e vetëdijesimit të nxënësve dhe prindërve për pasojat, bashkëpunimin më të madh ndërmjet nxënësve, mësimdhënësve, prindërve dhe drejtorit të shkollës, metodologjinë e mësimdhënies dhe nxënies, pajisjen e shkollave me pedagogë dhe psikologë, fuqizimin e masave ndëshkuese për nxënësit që nuk e ndjekin mësimin me rregull dhe

bëjnë shkeljen e rregullave të shkollës etj. Propozimet dhe sugjerimet në përqindjen më të madhe ndërlidhen me vetëdijesimin e prindërve dhe fuqizimin e rolit të tyre në shkollë. Pra, edhe nxënësit, edhe mësimdhënësit kërkojnë që prindërit të jenë më tepër pjesë e vendimmarrjes dhe të punojnë më shumë me fëmijët për zvogëlimin e numrit të mungesave, të cilat i detyrojnë shkollat të bëjnë përjashtimin e disa nxënësve nga procesi mësimor, apo transferimin e tyre në ndonjë shkollë tjetër, pasi përjashtimi apo transferimi në një shkollë tjetër, në të shumtën e rasteve, çon në braktisjen e shkollës nga ana e nxënësve.

Pa vijueshmëri të rregullt të mësimin nga ana e nxënësve, nuk mund të priten rezultate në mësim dhe të kemi shkolla cilësore.


4. 2. Rezultatet e dala nga intervistat me drejtorët e shkollave

Mungesat e shpeshta të nxënësve në procesin mësimor janë pengesë e madhe në rritjen e cilësisë pothuajse në të gjitha shkollat e mesme. Sipas tyre, nuk mund të ketë ngritje të cilësisë në shkolla kur një numër i nxënësve mungojnë në mësim, vonohen në orë apo ikin nga orët për arsye të ndryshme.

Drejtorët, gjatë intervistës, janë pyetur për numrin e mungesave të nxënësve, për orët në të cilat mungojnë më shpesh, për arsyet e ikjes nga orët e mësimin, për përjashtimet e nxënësve nga orët e mësimin nga ana e mësimdhënësve, për pasojat që sjellin ato, për masat e ndërmarra dhe për bashkëpunimin e shkollës me prindër të nxënësve.

Numri i mungesave të nxënësve

Pjesa më e madhe e drejtorëve të shkollave të përfshirë në hulumtim, rreth 74 %, kanë thënë se numri i mungesave është mesatar, ndërsa 24 % kanë thënë se është i lartë. Vetëm 2 % nga drejtorët e shkollave kanë deklaruar se numri i mungesave në shkollën e tyre është i ulët. Në grafikun në vazhdim shihen përgjigjet e drejtorëve të shkollave lidhur me numrin e mungesave të nxënësve në procesin mësimor.




Grafiku 14. Numri i mungesave të nxënësve

Orët e mësimit në të cilat zakonisht nxënësit mungojnë

Sa i përket kohës së kur nxënësit mungojnë më shpesh në orët e mësimit, drejtorët e shkollave kanë dhënë përgjigje të ndryshme. 62 % kanë thënë se mungojnë në orët e fundit, 29 % në orën e parë, ndërsa 9 % kanë deklaruar se mungojnë tërë ditën. Sipas

përgjigjeve të drejtorëve, shumica e mungesave bëhen në orët e fundit të mësimit, pasuar me orët e para të mësimit, kur nxënësit vonohen dhe nuk hyjnë fare në mësim, ose edhe nuk lihen të futen në shkollë nga kujdestarët e ditës ose arsimtarët pasi të fillojë procesi mësimor. Në numër më të vogël, krahasuar me mungesat e disaorëshe, janë mungesat ditore të nxënësve. (Grafiku 15).




Grafiku 15. Orët në të cilat nxënësit mungojnë

Arsyet më të shpeshta që disa nxënës mungojnë në orët e mësimit

Ka shumë arsye, sipas drejtorëve të shkollave, pse nxënësit mungojnë në mësim, por arsyeja kryesore, sipas tyre, janë vetë prindërit, të cilët nuk kujdesën sa duhet për fëmijët e vet. 52 % e drejtorëve kanë deklaruar se arsyeja më e shpeshtë pse nxënësit mungojnë janë prindërit e nxënësve, kurse gati 1/3 e tyre, mendojnë se kushtet ekonomike – pasi disa nxënës janë mbajtës të familjes, ndikojnë në numrin e madh të mungesave të nxënësve.


Rreth 20 % prej tyre, shprehen se nxënësit ikin nga orët e mësim, sepse nuk u pëlqen shkolla.



Grafiku 16. Arsyet e mungesave

Arsyet e ikjes së nxënësve nga orët mësimore


Përveç mungesave tërë ditore dhe në orën e parë të mësim, problem mjaft i theksuar janë edhe ikjet e nxënësve nga orët e mësim dhe kjo bëhet për arsye të ndryshme. Sipas drejtorëve të përfshirë në hulumtim, janë disa arsye pse nxënësit ikin nga orët e mësim, si mospërgatitja apo mosinteresimi për mësim, nuk u pëlqen lënda apo mësimdhënësi, etj. 41 % kanë thënë nuk u pëlqen lënda, 34 nuk janë të përgatitur për orën e mësim (nuk i kanë bërë detyrat e shtëpisë), 4 % kanë dhëna arsye të tjera. (Grafiku 17).



Grafiku 17. Arsyet e ikjeve nga orët e mësimit

Vendqëndrimi i nxënësve që ikin nga orët e mësimit ose përjashtohen nga mësimdhënësit

Shqetësuese dhe mjaft brengosëse janë vendet ku qëndrojnë nxënësit që ikin nga orët e mësimit. Në mënyrë që mos të vërehen nga mësimdhënësit apo drejtori i shkollës, nxënësit zgjedhin lokacione shpeshherë të rrezikshme dhe aspak të pranueshme për nxënës për të qëndruar deri sa të fillojë ora tjetër, apo deri në fund të procesit mësimor. Në të shumtën e rasteve, nxënësit që ikin nga orët e mësimit qëndrojnë në kafenetë afër shkollës, në oborr të shkollës, në lojëra të fatit etj. 56 % e drejtorëve kanë thënë se nxënësit, më tepër qëndrojnë në lokalet e lojërave të fatit, duke shpenzuar para, 29 % kanë thënë se qëndrojnë në kafene të ndryshme, ndërsa 15 % kanë thënë se qëndrojnë në oborr të shkollës ose vende të ndryshme, pa përjashtuar edhe shtëpinë. (Grafiku 18).




Grafiku 18. Vendqëndrimet e nxënësve që ikin ose përjashtohen nga orët e mësimit

Përjashtimi i nxënësve prej orës së mësimit nga mësimdhënësit

Përveç mungesës së nxënësve në mësim, ikjeve nga orët, dukuri shqetësuese, e cila assesi nuk do të duhej të ndodhte, është edhe përjashtimi i nxënësve nga ora e mësimit për arsye të ndryshme. Sipas drejtorëve të shkollave, arsyeja më e shpeshtë pse disa mësimdhënës i nxjerrin nxënësit nga ora është prishja e disiplinës në klasë, pengimi i nxënësve të tjerë gjatë orës, etj. Largimi i nxënësve nga ora e mësimit, për shkak të prishjes së disiplinës apo për ndonjë arsye tjetër, sipas shumicës së drejtorëve, ndodh rrallë. Vetëm 19 % kanë deklaruar se mësimdhënësit i largojnë shpesh nxënësit nga orët e mësimit, krahasuar me rreth 79 % që kanë deklaruar se kjo, në shkollat e tyre, ndodh rrallë, por, për dallim nga drejtorët, përgjigje tjetër japin nxënësit, sipas të cilëve largimi i nxënësve nga orët e mësimit në disa shkolla ndodh shpesh dhe kjo sipas nxënësve bëhet nga mësimdhënësit që

shkojnë në shkollë të papërgatitur për orën dhe të cilët nuk bëjnë sa duhet përpjekje që të gjithë nxënësit të angazhohen me detyra dhe të trajtohen si të barabartë brenda orës. Si pasojë e kësaj, ata lihen anash dhe u jepet mundësia për prishje të rendit dhe disiplinës në klasë. 2 % e drejtorëve janë shprehur se në shkollat e tyre asnjëherë nxënësit nuk nxirren jashtë nga orët e mësimit. (Grafiku 19).




Grafiku 19. Frekuenca e përjashtimi të nxënësve nga orët e mësimit

Përgjegjësit për mungesat e nxënësve në shkollë

Institucionet gjithmonë janë përgjegjëse për respektimin e rregulloreve, por sipas drejtorëve të shkollave, janë kujdestari i klasës, prindi dhe shkolla në përgjithësi, si organe vendimmarrëse brenda shkollës. Megjithatë, sipas tyre, disa prindër fare nuk interesohen për nxënësit e tyre, ndërsa kur merren masa reagojnë pa pasur të drejtë. 64 % e drejtorëve të përfshirë në hulumtim kanë thënë se përgjegjës për mungesat e nxënësve në procesin mësimor janë prindërit, të cilët nuk bashkëpunojnë sa duhet me shkollën

dhe nuk i marrin përgjegjësitë që u takojnë me ligj, 22 % i fajësojnë mësuesit- veçanërisht kujdestarët e klasave, ndërsa vetëm 14 % e drejtorëve të shkollave i bëjnë përgjegjës organet drejtuese: drejtorët e shkollave apo Drejtoritë Komunale të Arsimit (Grafiku 20).



Grafiku 20. Përgjegjësit për mungesat e nxënësve në shkollë

Pasojat për nxënësit që sjellin mungesat e shumta në orët e mësimit

Kur nxënësit mungojnë në orët e mësimit, përveçse rrezikojnë të humbin të drejtën për shkollim, paraqesin problem edhe për mbarëvajtjen e mësimit dhe janë pengesë edhe për vetë mësuesit dhe nxënësit e tjerë. Pasojat, sipas drejtorëve, janë të shumta, si: nxënësit mbesin mbrapa në mësim dhe mësuesit e kanë vështirë të bëjnë vlerësimin e tyre, mund të humbin të drejtën e shkollimit dhe të përjashtohen nga shkolla e më këtë rritet numri i delikuentëve

Bashkëpunimi dhe komunikimi me prindërit

Drejtorët e përfshirë në hulumtim kanë deklaruar se shkollat vazhdimisht angazhohen që nxënësit të mos mungojnë në mësim dhe të jenë të rregullt në shkollë. Trajtimi i kësaj problematike, sipas drejtorëve, bëhet në forma të ndryshme, me anë të bisedave të vazhdueshme me nxënës dhe prindër nga ana e kujdestarit të klasës, të mësimdhënësve të tjerë, por edhe të vetë drejtorit të shkollës dhe personave të tjerë brenda shkollës. Bisedat me nxënës janë të rregullta nga mësimdhënësit, ndërsa bisedat me prindër bëhen në forma të ndryshme, përmes takimeve të rregullta dhe sipas nevojës edhe përmes e-mailit, telefonit, letërkëmbimeve dhe formave të tjera të komunikimit bashkëkohor. Prindërit informohen vazhdimisht për nxënësit që mungojnë në mësim, por, sipas tyre, interesimi i disa prindërve, posaçërisht i atyre të nxënësve që mungojnë në procesin mësimor, nuk është në nivelin e duhur dhe kontributi i tyre është mjaft i vogël.

Masat e shkollës ndaj nxënësve

Shkollat marrin masa ndaj nxënësve gjithmonë në pajtim me legjislacionin në fuqi pa u shkelur të drejtat e nxënësve. Masat e ndërmarra nga shkollat, pasi të detajohen shkaqet e mungesave të nxënësve në procesin mësimor, janë të ndryshme dhe mbështeten në rregulloret dhe udhëzimet administrative në fuqi. Ato janë: qortimi i nxënësit me gojë dhe me shkrim, informimi i prindërit, thyerja e notës së sjelljes, pezullimi, transferimi në një shkollë tjetër, por edhe largimi nga shkolla në rastet kur tejkalohej numri i mungesave të lejuara dhe nëse masat më të lehta të ndërmarra më parë, nuk kanë dhënë rezultatet e pritura dhe nuk kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes. Sipas drejtorëve të shkollave, me ligj

do të duhej që të praktikoheshin masa edhe ndaj prindërve, por meqë shkollimi i mesëm i lartë nuk është i obligueshëm, mbetet më tepër në vullnetin e prindërve që të ndikojnë te fëmijët e vet që të jenë të rregullt në mësim, duke u shpjeguar se ndjekja e mësimave me rregull është në të mirën e tyre dhe ndikon në ardhmërinë e vetë nxënësve.

Drejtorët e përfshirë në hulumtim kanë deklaruar se shkollat duhet të kenë autonomi më të madhe dhe të mos ketë ndërhyrje të faktorit komunal. Po ashtu, sipas tyre, është i domosdoshëm funksionimi i trekëndëshi prind-nxënës-mësimdhënës. Duhet të fuqizohet bashkëpunimi me prindër dhe të shtohen format e komunikimit, për të krijuar një klimë më të mirë për mësim si dhe të gjenden mënyrat e përshtatshme për stimulimin e nxënësve. Prindërit duhet të mbajnë lidhje më të mira me kujdestarin e klasës dhe me Drejtorinë e shkollës, të krijojnë kushte me të mira ekonomike, të bisedojnë me nxënësit për pasojat e mëtutjeshme nëse nuk i ndjekin mësimet me rregull dhe të përcjellin vazhdimisht vijimin e mësimet nga fëmijët.

Sa u përket akteve ligjore në fuqi, shumica prej drejtorëve nuk janë të kënaqur me to, ngase, sipas tyre, shkollat duhet të kenë më tepër autonomi në marrjen e vendimeve, të mos ketë ndërhyrje të tjera nga DKA-të dhe faktorët e tjerë. Disa nga drejtorët kanë kërkuar të ashpërsohen masat ligjore sa i përket vijueshmërisë së mësimet nga ana e nxënësve në procesin mësimor, si kusht për parandalimin e braktisjes së shkollës nga ana e disa nxënësve.

Shkollat, sipas tyre, vazhdojnë të përballen me mjaft sfida dhe vështirësi, por sfidat më të mëdha deklarohen ata, janë zhveshja e drejtorëve të shkollave nga kompetencat, komunikimi dhe bashkëpunimi shumë i zbehtë në mes të prindërit dhe shkollës,

vetëdijesimi i nxënësve për pasojat nëse nuk i ndjekin mësimet me rregull dhe mungojnë pa arsye. Po ashtu, sfidë mjaft e madhe dhe vështirë e kalueshme mbetet gjendja ekonomike e disa nxënësve dhe përmirësimi i qasjes së disa mësimdhënësve ndaj nxënësve, me qëllim që të ndërpritet largimi i nxënësve nga mësimi për shkak të përzgjedhjes jo të duhur të formave të punës.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1. Përfundime

Nga analiza e përgjithshme e rezultateve të hulumtimit mund të konstatojmë se ndër problemet e shumta, me të cilat përballen shkollat e mesme të larta në Kosovë, janë mungesat e nxënësve në procesin mësimor. Përveç vonesave në orën e parë të mësimit, është i madh edhe numri i nxënësve që mungojnë tërë ditën dhe nuk janë në gjendje t'i arsyetojnë mungesat e veta.

Problem tjetër janë edhe ikjet e nxënësve nga orët e mësimit, për shkak se shkojnë të papërgatitur në shkollë, nuk u pëlqen lënda ose arsimitari, ose për shkak se orët e mësimit nuk janë mjaftueshëm tërheqëse për ta. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se një ndër arsytet që nxënësit detyrohen të ikin nga orët e mësimit janë mësimdhënësit me vlerësimin e tyre, ngase ata shpesh dinë t'i ndëshkojnë nxënësit me notë negative.

Ajo që shqetëson më së shumti është se në shumicën e shkollave, disa mësimdhënës akoma vazhdojnë t'i përjashtojnë nxënësit nga ora e mësimit për shkak të prishjes së rendit dhe disiplinës brenda klasës. Përjashtimi i nxënësve nga ora e mësimit bëhet zakonisht nga ata mësimdhënës që shkojnë në shkollë të papërgatitur, ose që nuk janë të trajnuar për të menaxhuar me sukses orën. Nxënësit që nuk arrijnë të bëhen pjesë e grupit dhe nuk ndihen të barabartë me të tjerët brenda klasës, bëhen pengesë për nxënësit e tjerë. Në situata të këtilla, mësimdhënësit marrin vendimin më të papranueshëm - nxjerrjen e tyre nga ora e mësimit. Kjo tashmë ka filluar të kalojë në shprehje të një numër i mësimdhënësve dhe i nxënësve, prandaj nxënësit kanë filluar të kopjojnë njëri tjetrin në sjellje me qëllim që mësimdhënësit t'i përjashtojnë nga ora e

mësimi si zgjidhje më e „lehtë” për ta, pa bërë përpjekje që t’i bëjnë pjesë të vendimmarrjes dhe të ndihen të rëndësishëm në klasë.

Shkaqet e mungesës së nxënësve në procesin mësimor janë të shumta dhe të ndryshme, si mungesa e motivimit, mësimdhënia jo atraktive, mbingarkesa e planeve dhe programeve mësimore, mjediset e papërshtatshme shkollore, dhuna dhe presioni, përkujdesja jo e duhur e prindërve, pengesat e udhëtimit, si dhe përdorimi i teknologjisë informative për lojëra dhe komunikime në rrjetet sociale.

Sipas nxënësve, përgjegjës kryesorë për numrin e madh të mungesave, janë prindërit dhe kujdestarët e klasës, ndërsa mësimdhënësit në një përqindje më të madhe i fajësojnë prindërit. Mbi 76 % mendojnë për të parët, pasuar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, kujdestarët e klasave dhe drejtorët.

Prindërit njoftohen vazhdimisht për nxënësit që mungojnë në mësim, por, sipas tyre, interesimi i disa prindërve, posaçërisht i atyre nxënësve që mungojnë në procesin mësimor nuk është në nivelin e duhur dhe kontributi i tyre është mjaft i vogël.

Shkaku i mungesave të paarsyeshme në mësim, nxënësit, më vonë, përballen me pasoja të shumta, si ngecin mbrapa me mësim, suspendohen apo transferohen në ndonjë shkollë tjetër dhe mund të humbasin të drejtën e shkolllimit.

Megjithatë, as DKA-të dhe as shkollat nuk kanë ndërtuar mekanizma të ndërhyrjes dhe të llogaridhënies për të informuar, apo raportuar, në mënyrë që të parandalohen mungesat e nxënësve dhe braktisja e shkollës.

5.2. Rekomandime

Në raportin e hulumtimit janë pasqyruar të gjitha sugjerimet nga grupet përkatëse: nxënës, mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave. Ato nuk janë thjesht një përmbledhje të dhënash, por rezultate të analizuara që rekomandojnë atë çfarë është e mundshme të ndërmerret në kushtet aktuale dhe çfarë duhet të bëhet.

- Deri më tani, nuk janë shfrytëzuar mundësitë e shkollave dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për ndryshimin e gjendjes. Prandaj, për përmirësimin e saj në të ardhmen nevojitet punë e përbashkët e nxënësve, e mësimdhënësve, e drejtuesve të shkollave, e prindërve dhe e ekspertëve të arsimit, duke u bazuar në gjendjen aktuale të shkollave.
- Bashkëpunimi shkollë-familje duhet të fuqizohet më tepër, si dhe të përdoren të gjitha format e komunikimit të organeve të shkollës me prindërit për të gjetur mënyrat më të përshtatshme të trajtimit të problemeve me kohë brenda shkollës, për të parandaluar mungesat e nxënësve në orët e mësimin.
- Përveç ngritjes së kapaciteteve të mësuesve dhe të drejtorëve të shkollave, rekomandohet edhe ngritja e kapaciteteve të prindërve për rritjen e bashkëpunimit në nivel shkolle, sidomos prindërve që janë anëtarë të këshillave të klasave dhe Këshillit Drejtues të Shkollës (KDSH), por edhe të prindërve të tjerë si dhe për të rritur angazhimin e prindërve që të ushtrojnë ndikim në interes të fëmijëve të tyre.

- Bashkëpunimi i mësimdhënësve dhe i drejtorëve të shkollave me prindër duhet të monitorohet dhe të vlerësohet nga DKA-të dhe MAShT-i. Shpeshësia dhe cilësia e takimeve të prindërve dhe të mësimdhënësve për marrëdhëniet e krijuara me prindërit dhe përfshirjen e tyre në jetën e shkollës të vlerësohen nga drejtori i shkollës, kurse angazhimi dhe rezultatet e drejtorëve për këto aspekte të vlerësohen nga DKA-ja.
- Për të nxitur dhe fuqizuar bashkëpunimin shkollë-familje, këshillohet të shfrytëzohet profesionalizmi i psikologëve, pedagogëve dhe punonjësve të tjerë, si burime njerëzore shtesë në dispozicion të prindërve.
- MAShT-i dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit duhet të marrin masa që të sigurojnë staf profesional brenda shkollave (pedagogë, psikologë dhe ekspertë të tjerë), jo në përputhje me numrin e nxënësve, por duke u bazuar në nevojat e nxënësve, të cilat mund të jenë specifike për secilën shkollë.
- Të fuqizohen ekipet për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM) dhe të punohet më tepër me nxënësit potencialë për të braktisur mësimin, që në të shumtën e rasteve këtë e bëjnë nxënësit që mungojnë shpesh në procesin mësimor. Këto ekipe të shfrytëzojnë çdo mundësi për të komunikuar me prindërit e nxënësve që mungojnë në mësim dhe jo të merren vetëm me nxënësit dhe t'i informojnë ata për pasojat dhe prindërit e tyre vetëm pasi që fëmijët të kenë braktisur shkollën.

- Mësimdhënësit të jenë të kujdesshëm gjatë vlerësimit, pasi pikërisht qëndrimi, vlerësimi dhe komunikimi jo i duhur i shtyn nxënësit të ikën nga orët mësimore. Mësimdhënësit të kenë sjellje të njëjtë me të gjithë nxënësit, të mos përdorin dhunë verbale ndaj tyre dhe të mos e nënçmojnë personalitetin e tyre.
- Të organizohen aktivitete të ndryshme në shkolla që shtojnë interesimin e nxënësve për mësim dhe të ndihmojnë në zvogëlimin e numrit të mungesave dhe rasteve të braktisjes së shkollës

Burimet dhe literatura

1. Bezati, Fatmir & Hoxhallari, Rozeta (2011) Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës, Fondacioni shoqëria e hapur për Shqipërinë, Tiranë.
2. Bojaxhi, Aleksandër (2004). „Disiplina në klasën mësimor”, „Toena”, Tiranë.
3. Bouchard, P. , (1999). Le programme Foyer: cinq ans de prévention du décrochage. *Vie pédagogique*, 113, 44-48.
4. Circulaire n° 2011-0018 du 31-1-2011 MEN - DGESCO B3-3
5. CTREQ- Le centre de transfert pour la réussite éducative du Québec (2007). Projet C-70 Pierre Potvin (Absentéisme scolaire).
6. Devetaku-Gojani, Hajrije, Mehmeti, Selim (2014) „Fëmijët jashtë shkollës në Kosovë”, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
7. Didat, Roger (1997). *Pour une approche globale de l'élève*, CRDP de l'académie d'Amiens, 1997, p. 10-11.
8. Fullan, Michael (1999). „Forcat e ndryshimit”, Tiranë.
9. Galand, Benoît (2004) e rôle du contexte scolaire et de la démotivation dans l'absentéisme des élève, *Revue des sciences de l'éducation*, vol. 30, n 1, 2004, p. 125-142.
10. GIZ (2012). Moduli „Komunikimi dhe bashkëpunimi”, Prishtinë.

11. Grup autorësh (2004). Analiza e gjendjes së arsimit në Kosovë, UNICEF, Prishtinë.
12. Grup autorësh (2008). Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, MASHT, Prishtinë.
13. Grup autorësh (2002). Disa aspekte të efikasitetit në Arsimin e Kosovës, KEC, Prishtinë.
14. Grup autorësh (2005). Doracak – pako strategjish, Të gjithë në shkollë. Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkollë, CRS, Prishtinë
15. Grup autorësh (2010). Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
16. HUERRE Patrice, LEROY Pascale (2006). L'absentéisme scolaire, du normal au pathologique, collection Essais, Hachette, 335 p
17. Le people, Quotidien belge de combat pour nos valeurs, 22 septembre 2015, 1668
18. Le progress, Education, Absentéisme scolaire, quelles sanctions?, 11. 02. 2015
19. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011): Ligji për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Prishtinë.
20. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013). Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë, Prishtinë.
21. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Prishtinë.

22. Manca, Roberto (2004). Absentéisme et sécurité des élèves, *Éduquer* [En ligne], 7.
23. MASHT (2014). Udhëzimin administrativ Nr. 06/2014: Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta, Prishtinë.
24. MASHT (2008). Plani Kombëtar i veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014, Prishtinë.
25. MASHT (2012): UA për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsim të obliguar (EPRBM).
26. MASHT (2008). Treguesit dhe të dhënat statistikore në arsim 2004/05, 05/06, 06/07
27. MASHT (2014). „Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë”, doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, Prishtinë.
28. MASHT (2011). Udhëzimi Administrativ: Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar.
29. MASHT (2009), Plani kombëtar i veprimit kundër braktisjes 2009-2014, Prishtinë.
30. MASHT (2011), Udhëzimi administrativ, Kodi i etikës për vlerësimin e nxënësve, Prishtinë
31. Miller, Bonnie (2014). “Komunikimi me fëmijë”, Prishtinë.
32. Musai Bardhyl (2003), Metodologji e mësimdhënies, Tiranë

33. Prairat, Eirick (1999). Penser la sanction Revue française de pédagogie Année 1999 Volume 127 Numéro 1 pp. 107-117
34. Projet C-70 Pierre Potvin 2007-11-05 Absentéisme scolaire
35. Qendra për Arsim e Kosovës (2012). Politika për parandalimin e braktisjes së shkollimit, KEC, Prishtinë. http://kec-ks.org/document's/Parandalimi_i_braktisjes.pdf
36. Shala, Safete, (2014). „Shkaqet e humbjes së interesimit të nxënësve për mësim”, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2014.
37. Saulnier, Julie, publié le 12/07/2010 à 18:46
38. Zaplluzha, Shpresa (2016), Viktimizimi i adoleshentëve dhe shkaqet e pasigurisë tek nxënësit e shkollave të mesme në Prizren, Tiranë
39. Zuna A. Deva & bashkëpunëtorët (2009). Partneriteti shkollë-familje-komunitet, sfidë vijanoze”, Prishtinë.
40. www.koha.net 19 tetor, 2016.

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja “Blendi” Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

373.52(496.51)

Morina, Bekim

Mungesat e nxënësve në procesin mësimor në shkollat e mesme të larta në Kosovë / Bekim Morina, Skender Mekolli. – Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016. – 90 f. : ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Literatura : f. 86-89

1. Mekolli, Skender

ISBN 978-9951-591-36-2

ISBN 978-9951-591-36-2



9 789951 591362